



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO  
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS  
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

## Raporti Vjetor IADK 2013



Adresa:  
Fshati Sfarëqak i Ulët, p.n  
42000 Vushtrri  
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!  
Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadc.org](mailto:info@iadc.org)  
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726  
Web: [www.iadc.org](http://www.iadc.org)

## Hyrje

Pas sukseseve dhe angazhimeve të shumta të IADK-se në sektorin e bujqësisë dhe përpjekjeve të vazhdueshme për të krijuar kushte sa më të mira në edukimin dhe konsolidimin e fermerëve, IADK gjatë vitit 2013 ka hapur Qendrën për Trajnimin e Fermerëve në fshatin Sfaracak i Ulët komuna e Vushtrrisë. Kjo qendër është e para e këtij lloji në Kosovë dhe do të shërbejë për fermerët në edukimin dhe demonstrimin e praktikave të reja në sektorin e bujqësisë në Kosovë. Viti 2013 për IADK karakterizohet si viti i vazhdimit të përkrahjes së partnereve dhe donatoreve të ndryshëm siç janë: **Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë me dy projekte**: atë të Zhvillimit të Turizmit Rural në regionin e Shalës dhe Fuqizimin e Shoqërisë Civile në sektorin e Bujqësisë; **donatorët nga Gjermania (EED), Finlanda (FCA) dhe Suedia (CoS)** në projektin “Edukimi dhe Konsolidimi i Fermerëve në Kosovë”; **Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës** në projektin e “Rrjetit të Kontabilitetit të Fermave në Kosovë” dhe Partneret si **PUM** nga Holanda dhe **AFDI** nga Franca. Të gjitha projektet e lartpërmendura që janë zbatuar gjatë vitit 2013 si qëllim kryesor kanë pasur zhvillimin e bujqësisë, rritjen e prodhimit të bujqësorë, uljen e kostos së prodhimit, ngritjen e sigurisë së ushqimit, promovimin e prodhimeve vendore, fuqizimin e fermerëve dhe krijimin e kushteve sa më të mira në zonat rurale. Këto projekte kanë ndikuar në zbatimin e mirëfilltë të strategjisë zhvillimore të IADK 2012-2018. Një sukses tjetër nga IADK është edhe konsolidimi i fermerëve në nivel nacional duke përkrahur këtë konsolidim përmes dy projekteve që si rezultat u themelua “Bashkimi i Shoqatave Bujqësore të Kosovës” (BSHBK) që nënkupton organizimin e fermerëve në mbrojtjen e interesave të tyre dhe në rritjen e kapaciteteve ndikuese të fermerëve në vendimmarrje. Organizimi fermerëve në nivel vendi shënon një të arritur që do të ndikojë në përmirësimin e kushteve të fermerëve në Kosovë dhe tani BSHBK-ja ka zyrat e saj dhe strukturat organizative që angazhohen për të qenë sa më afër fermerëve dhe nevojave të tyre. Për IADK-në mbetet prioritet ngritja e njohurive, përdorimi i teknikave dhe teknologjive të reja tek fermerët, përfitimet nga programet tona të kenë si qëllim ngritjen e prodhimit të bujqësorë, cilësisë, sasisë dhe uljes së kostos së prodhimit. IADK beson që me një bashkëpunim të ngushtë të ekipit profesional të saj, fermerëve, komunave, MBPZhR si dhe partnerëve e donatorëve vendor dhe ndërkombëtar do të kontribuojmë në përmirësimin e prodhimit të bujqësorë, zvogëlimin e importit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.



Zenel Bunjaku- Drejtor Ekzekutiv i IADK-së

## Partneret që kanë mbështetur projektet e IADK gjatë vitit 2013

IADK fale sukseseve dhe rezultateve ne sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural ka krijuar një eksperiencë dhe besueshmëri tek partneret dhe donatoret e ndryshme. Organizata është duke implementuar projektin tre vjeçar (2012-2014) i financuar nga një konzorcium donatorësh **Finn Church Aid FCA** (nga Finland), **Evangelischer Entwicklungsdienst EED** (Gjermania) dhe **Church of Sweden CoS** (nga Suedia) lidhur me edukimin dhe organizimin e fermerëve, si dhe me prezantimin e aktiviteteve të reja bujqësore.

Për të forcuar qëndrueshmërinë e IADK-së, **EED** nga Gjermania ka përkrahur ndërtimin e Qendrës për Edukimin e Fermerëve që do të udhëhiqet nga IADK. Qendra për Edukimin e Fermerëve është ndërtuar dhe është lëshuar ne funksion gjate këtij viti. Kjo qendër është e para e këtij lloji ne Kosove dhe do te shërbej si qendër edukative dhe demonstruese ne sektorin e bujqësisë.

Partner tjetër i rëndësishëm është **Bashkimi Evropian** që ka financuar dy projekte:

Projekt dyvjeçar 2013-2014 në Promovimin e turizmit rural dhe krijimin e infrastrukturës ne zonën e Shalës.

Projekti dyvjeçar 2012-2014 ne fuqizimin e shoqërisë civile ne polik bërje ne sektorin e bujqësisë.

Projektin dy vjeçar 2013-2014 ne Rrjetin e kontabilitetit te fermave ne Kosove

Me qellim te ngritjes se kapaciteteve te stafit te IADK dhe promovimit te praktikave te reja ne sektorin e bujqësisë, gjate vitit 2013 ka vazhduar bashkëpunimi me organizatat me **Ekspertet Seniorë nga Holanda (PUM)** dhe me **Shoqatën e Fermerëve nga Normandia e Ultë të Francës (AFDI)** ku me këto dy organizata është bere shkëmbimi i përvojave ne sektorët e bujqësisë.

## Shtrirja e aktiviteteve:

Komunat Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Drenas dhe Podujevë, ndërsa me projektet fuqizimin e shoqërisë civile ne politik bërje ne sektorin e bujqësisë dhe ne rrjetin e kontabilitetit te fermave në tërë Kosovën.

## Departamentet kryesore të IADK-së janë:

### Hortikulture:

**Pemët**, ku përfshihen mollët, kumbullat, dredhëza, mjedra dhe manaferra

**Perimet**, ku përfshihen kultivimi i domates, specit, trangujt, sallatat, spinaqit dhe kultivimi i fidanëve të perimeve në serra.

**Frutat pyjore dhe bimët mjekuese** ku përfshihet grumbullimi dhe tharja e frutave malore dhe bimëve mjekuese si dhe kultivimin e tyre, shfrytëzimin e energjisë se ripërtrishme ne sektorin e tharjes se frutave malore dhe ne sistemin e ujitjes.

**Blegtoria**, Ku përfshihen gjedhet delet dhe dhit prodhimi dhe përpunimi i qumështit, ushqimi për kafshë, përmirësimi racor, aplikimi i teknologjive te reja dhe mekanizmi bujqësor, shfrytëzimin e energjisë se ripërtrishme ne sektorin e përpunimit te qumështit.

**Organizimi i fermerëve**, ku përfshihen organizimin e fermerëve në nivel lokal dhe nacional dhe fuqizimin e shoqërisë civile ne politik bërje ne sektorin e bujqësisë.

**Përpunimi i ushqimit shtëpiak**, ku përfshihen përpunimi i qumështit, pemëve dhe perimeve, organizimi i grave ne shoqata.

**Turizmi rural**, ku si qellim kryesor ka promovimin dhe zhvillimin e turizmit rural dhe krijimin e infrastrukturës.

### Brenda çdo departamenti ekipet tona synojnë që:

- Fermerët te rrisin aftësitë konkurruese në treg
- Te ulin importin e produkteve bujqësore dhe ngritjen e kapaciteteve eksportuese ne sektorin e bujqësisë.
- Te përmirësojnë mjedisin në të cilin veprojnë fermerët, duke ju krijuar infrastrukturë më të mirë prodhuese dhe përpunuese.
- Rritjen e sigurisë se ushqimit dhe përmirësimin e kualitetit te prodhimeve bujqësore.
- Sjelljen e risive ne sektorin e bujqësisë
- Mbrojtën e mjedisit
- Fuqizimin e grave ne zonat rurale
- Përkrahjen e institucioneve përkatëse ne implementimin e strategjive zhvillimore

## Përfituesit e programit për vitin 2013

- 221 Familje kanë përfituar mbështetje direkt nga programet e IADK:** pajisje për prodhimin e energjisë së ripërtrishme në bujqësi, pajisje për ftohjen e qumështit, pako higjienike për përmirësimin e kualitetit të qumështit, makina mjelëse për lope dhe dhi, makina për qethjen e deleve, pula vojse, serra, inpute për kultivimi i bimëve aromatike mjekësore, inpute për kultivimi i mjedrës dhe manaferrës, tharëse për bime mjekësore, pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve, restaurim të mullirit tradicional me uje, rregullimin e odave/bujtinave për turist, rregullim të shtegur për hecje për këmbësor, rregullim të urës, ndërtimin e krojeve dhe vendpushimeve për turist.
- 190 Fermerë, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së,** kanë marrë pjesë në 29 vizita në: Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Francë, Gjermani, Holandë, Ceki, Itali, Zvicër dhe Turqi.
- 1978 Fermerë (pjesëmarrës),** kanë marrë pjesë në 203 sesione të trajnimeve, ku:
- 33 Sesione të trajnimeve në sektorin e Blegtorisë,** 199 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 68 Sesione të trajnimeve në sektorin e Hortikulturës,** 672 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 10 Sesione të trajnimeve në sektorin e Përpunimit Shtëpiak,** 104 pjesëmarrëse kanë marrë pjesë.
- 52 Sesione të trajnimeve janë mbajtur në Organizimin e fermerëve,** ku kanë marrë pjesë 604 pjesëmarrës
- 40 Sesione të trajnimeve janë mbajtur në sektorin e Menaxhimit të Bizneseve,** 399 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 2 Publikime praktike - broshura** “Prodhimtaria organike e bimëve mjekësore dhe
- 23 Fletëpalosje** në sektorët e ndryshme të bujqësisë
- 13 Workshope,** ku kanë marrë pjesë 381 pjesëmarrës nga sektorët e ndryshme të bujqësisë.
- 6 Promovime** të projekteve janë mbajtur ku kanë marrë pjesë 260 pjesëmarrës
- 2 Dite fushore,** ku kanë marrë pjesë 238 pjesëmarrës
- 4 Tryeza të rrumbullakëta,** ku kanë marrë pjesë 100 pjesëmarrës
- 3 Pjesëmarrja në Panaire Regjionale të Bujqësisë -** mbi 104 fermerë kanë ekspozuar produktet e tyre
- 3 Partnerë ndërkombëtar,** AFDI, PUM, FFRM

Stafi i IADK-së ka kontribuar nëpërmjet grupeve të ndryshme punuese në përgatitjen e strategjive, ligjeve, kritereve etj., të cilat janë organizuar nga institucionet dhe organizatat lokale, regjionale dhe kombëtare.



## DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

### Përkrahja e fermerëve të dhive me makina mjelëse

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të qumështit të dhisë dhe modernizmit të fermave të dhive, IADK gjate këtij viti ka përkrahur 14 fermere me makina mjelëse dhe pajisje higjienike. Varësisht nga numri i dhive fermerët kanë përfituar nga një ose dy makina mjelëse dhe nga një pako higjienike. Secila makinë mjelëse ka nga dy tufa mjelëse ndërsa pakoja higjienike përmban këto pajisje: acid dhe baze për pastrimin e makinave mjelëse, jod për dezinfektimin e gjirit të dhive, CMT testin për identifikimin e mastitit, gotat për paramjelje, gotat për dezinfektim të gjirit dhe tri lloje të brushave për pastrimin e makinave mjelëse. Me qëllim të lehtësimit të procesit të mjeljes dhe shfrytëzimit sa më të mirë të makinave mjelëse, IADK ka përgatitur edhe planin e ndërtimit të vendit të mjeljes, ku secili përfitues ka bërë rregullimin e vendit të mjeljes sipas standardeve.



Po ashtu të gjithë përfituesit janë trajnuar në aspektin praktik rreth të ushqyerit e dhive, përmirësimin e kualiteti të qumështit dhe përgatitjen e silazhit të misrit. Si rezultat i përdorimit të makinave mjelëse është përmirësuar dukshëm kualiteti i qumështit, po ashtu fermerët kanë rritur te hyrat në fermat e tyre.

### Shpërndarja e makinave për qethjen e deleve

Gjate vitit 2013 IADK ka përkrahur fermerët e deleve me makina për qethjen e deleve. Përfitues të këtyre makinave qethëse janë fermerët e Regjionit të Mitrovicës, që shtrihen në zonën e Shalës nga fshatrat Bajgore, Bare dhe Sllakovc. Qëllimi i këtij projekti ka qenë që fermerëve të ju lehtësohet puna në qethjen e deleve, pasi deri më tani fermerët qethjen e kanë bërë me gërshërë, ku për qethjen e deleve kanë shpenzuar më shumë kohë. Po ashtu me përdorimin e makinave qethëse edhe kualiteti i leshit do të përmirësohet. IADK-ja do të vazhdojë të përkrah sektorin e deleve me aktivitete tjera, ku gjatë këtij viti janë trajnuar fermerët në:



balancimin e racioneve ushqyese, përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe përgatitjen e silazhës së misrit.

### **Shpërndarja e makinave mjelëse për lopë**

Me qëllim të përkrahjes së fermerëve të cilët janë të orientuar nga tregu dhe rritjes së fermave në sektorin e blegtorisë IADK-ja gjatë këtij viti ka përkrahur 14 fermere nga komuniteti shqiptar dhe serb me nga një makinë mjelëse dhe pako higjienike. Po ashtu të gjithë përfituesit janë trajnuar në aspektin praktik në përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe menaxhimit të fermave qumështore. Të gjithë përfituesit kanë arritur të prodhojnë rreth 23,147 litra qumësht ku në të njëjtën kohë kanë përmirësuar kualitetin e qumështit dhe kanë rritur të hyrat në fermat e tyre.

### **Promovimi prodhimit të vezëve organike**

Me qëllim të promovimit të prodhimit të vezëve organike në viset rurale, IADK gjatë viti 2013 ka përkrahur 5 fermere me pula vojse. Secili përfitues ka përfituar nga 100 pula ku në total janë shpërndarë 500 pula 18 javëshe. Me qëllim të plotësimit të kushteve në mirëmbajtjen e tyre IADK ka përkrahur përfituesit edhe me ndërtimin e kafazeve për mbajtjen e pulave në sistem të lirë. Po ashtu të gjithë përfituesit janë trajnuar në aspektin praktik në të ushqyerit e pulave, përgatitjen e koncentreve dhe në parandalimin dhe mbrojtjen nga sëmundjet e ndryshme. Si rezultat i këtij aktiviteti është se fermerët kanë filluar të dalin në treg me prodhimet e tyre, ku gjatë kësaj periudhe fermerët kanë shitur rreth 15,500 vezë dhe është rritur vetëdijësimi i banorëve në zonat rurale në mbajtjen dhe kultivimin e pulave.



### **Përkrahja e shoqatës së deleve dhe dhive**

Me qëllim të fuqizimit të shoqatës së deleve dhe dhive në nivel të Kosovës IADK gjatë vitit 2013 ka përkrahur këtë shoqatë në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe sigurimin e pajisjeve për zyre. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave në menaxhimin dhe funksionalizimin e shoqatës IADK ka organizuar dy vizita studimore në Maqedoni dhe në Francë, gjatë këtyre vizitave kanë marrë pjesë 15 fermere.

### **Instalimi i pajisjeve ftohëse të qumështit (laktofrizave) në fermë**

Me qëllim të përmirimit të kushteve të fermës dhe përmirimit të kualitetit të qumështit, edhe gjatë vitit 2013 IADK ka përkrahur fermerët me shpërndarjen e laktofrizit dhe pajisje tjera për grumbullimin dhe ruajtjen e qumështit.

Duke parë se një ndër problemet kryesore në përmirësimin e kualitetit të qumështit është se fermerët nuk kanë pajisje adekuate për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit, IADK ka përkrahur 1 fermere me pajisje për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit, me kapacitet të grumbullimit të qumështit 1000 litër qumësht në ditë. Pas instalimit të laktofrizit kjo pikë ka filluar të bëjë grumbullimin e qumështit ku 13 fermerë dorëzojnë 850 litër qumësht në ditë.



### **Implementimi i praktikave të mira në menaxhimin e pikave grumbulluese të qumështit (GMP)**

Gjatë vitit 2013 IADK ka vazhduar në implementimin e standardit të GMP në pikat grumbulluese të qumështit. Gjatë këtij viti IADK ka përgatitur të gjitha dokumentacionet e nevojshme që kërkon standardi dhe është implementuar GMP në 3 pika grumbulluese të qumështit. Pas implementimit të GMP pikat grumbulluese të qumështit kanë përmirësuar kualitetin e qumështit dhe është rritur mirëbesimi në mes të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit.

### **Organizimi i vizitës së fermerëve nga Maqedonia në Kosovë**

Gjate këtij viti, IADK ka organizuar vizitë studimore në Kosovë për fermerët nga Maqedonia. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 15 fermerëve prodhues të qumështit dhe ushqimit të kafshëve. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët nga Maqedonia të njihen me eksperiencat e fermerëve Kosovarë dhe të bëhet shkëmbimi i përvojave të tyre. Gjatë kësaj vizite fermerët nga Maqedonia kanë pasur rastin të njihen me funksionimin e model fermës për lopë qumështore, funksionimin e grumbullimit të qumështit si dhe shfrytëzimin e energjisë alternative për pasterizimin e qumështit.



## DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS

### Fidanishtet e dredhëzave

Duke pasur parasysh rritjen e sipërfaqeve me dredhëza nga viti në vit dhe interesimin e fermerëve për tu furnizuar me fidanë cilësorë të dredhëzës IADK për herë të parë në Regjionin e Mitrovicës ka përkrahur tre fermer në ngritjen e fidanishteve për të prodhuar në mënyrë profesionale fidanë të dredhëzës. Dy fermerë përfitues janë nga Vushtrria dhe një nga Skënderaj, të cilët janë furnizuar me bimë amë të dredhëzës nga Holanda dhe Italia, për të ngritë fidanishte me sipërfaqe me nga 0.50 ha, si dhe me inpute tjera përcjellëse. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti ka qenë përfitimi i përvojave të fermerëve në këtë lëmi, pastaj sigurimi i fidanëve kualitative për fermerët që duan të zgjerojnë apo të ngrisin plantacione të reja me dredhëza si dhe ulja e kostos për ngritje të plantacioneve me dredhëza, duke u furnizuar fermerët nga këto fidanishte me fidanë kualitativë dhe me çmime më të favorshme krahasuar me fidanët e importuara. Fermerët përfitues të këtij projekti kanë prodhuar afër 450 mijë fidane cilësore të dredhëzave të kultivarëve Alba, Maya dhe Elsanta me çmim mesatar 0.13 €. Tre fermerët e përfshirë në këtë projekt kanë regjistruar bizneset e tyre dhe kanë marrë licencë si prodhues të materialit fidanorë të dredhëzës nga MBPZHR.



### Inkubatorët për mbirje të farave

Përkrahja e fermerëve me inkubatorë kishte për qëllim avancimin e prodhimtarisë së fidanëve të perimeve dhe luleve. Ndonëse shpërndarja e pesë inkubatorëve/dhomave mbirëse të farave të perimeve ka ndodhur një vit më parë, shfrytëzimi efektiv i tyre nga fermerët përfitues të cilët merren me prodhimin e fidanëve të perimeve dhe luleve ka ndodhur këtë vit. Në sajë të përparësive që kanë këta inkubatorë, është vërejtur një efekt shumë pozitivë i përdorimit të tyre si në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin kualitativë.



Përfituesit kanë rritur numrin e fidaneve të perimeve e të luleve, kanë mbjellë fidanet për së paku dy javë më vonë, si rezultat i mbishmërisë më të shpejtë që bëhet me inkubatorë. Përdorimi i inkubatorëve ka mundësuar për së paku 20% zvogëlimin e shpenzimeve të ngrohjes dhe përkujdesit për bimët, pastaj

mbishmëri më të madhe të farave, përmirësimin e cilësisë së fidanëve dhe zvogëlim të rrezikut të prekjës së fidanëve nga sëmundjet, në krahasim me metodat tradicionale të prodhimit të fidanëve, që këta përfitues e kanë aplikuar në vitet e mëparshme.

Tabela krahasuese më të dhënat e prodhimit të fidanëve në vitin 2012 dhe 2013, ku vërehet se gati është dyfishuar numri i fidanëve.

Nr.	Fermerët përfitues	Nr.i fid.të prodhuara në vitin 2012	Nr.i fid.të prodhura në vitin 2013
1.	Mehdi Bresilla	80 mijë fidane të perimeve	100 mijë fidane perimesh
2.	Halil Kadriu	80 mijë fidane të perimeve e të luleve	80 mijë fid.të specit 70 mijë fid.të luleve
3.	Refik Kuleta	60 mijë fidane të perimeve	66 mijë fid.të specit 6 mijë fid.të luleve
4.	Agim Shallci	45 mijë fidane të perimeve	55 mijë fid.të specit 3 mijë.fid.të luleve
5.	Driton Morina	20 mijë fidane	30 mij fidanë perimesh
<b>Gjithësej</b>		<b>285000</b>	<b>410000</b>

### Serra për prodhimtari organike të perimeve

Prodhimtaria e perimeve në mënyrë organike në serrën demonstruese ka filluar në pranverë të vitit 2013, në të cilën janë mbjellë 1100 bimë të domates dhe janë përdorur vetëm plehurat organike. Gjatë vegetacionit janë organizuar trajnime me dy grupe të fermerëve në nivel të Kosovës me qëllim të promovimit të teknikave të prodhimit organik të perimeve serrë.

Këto dy grupe të fermerëve kanë marrë pjesë në vizita dy ditore në Shqipëri për të parë kultivuesit e perimeve dhe përvojat e tyre në prodhimin organik të perimeve. Në sajë të përparësive që ka serra: si



ajrosja anësore dhe në kulmet e serrës, rrjeti anti insekt në dritaret për ajrosje, dhoma parahyresë që pengon futjen direkte të insekteve në serrë, pastaj sistemi pik-pikë i ujitjes, folja e zezë për mulqirim të tokës dhe përkujdesi i rregullt ndaj bimëve kanë mundësuar prodhimtari mesatarisht të lartë të domateve me kualitet dhe shije shumë të mirë të frutave, dhe nuk është bërë asnjë trajtim me preparate mbrojtëse. Serra ka sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> dhe gjatë vegetacionit maj-tetor 2013 janë prodhuar 5000 kg domate, ndërsa janë plasuar me një çmim mesatar prej 0.50 €/kg. Në fillim të vjeljes është organizuar një ditë fushore për të promovuar

prodhimin organik të domateve dhe në të kanë marrë pjesë fermerë dhe përfaqësues të drejtorive komunale për bujqësi nga komuna të ndryshme të Kosovës. Në fund të këtij viti IADK do të angazhojë një trupë inspektuese dhe certifikuese për të bërë certifikimin e prodhimeve organike në serrë.

### **Kultivimi i bimëve aromatike mjekësore**

Në kuadër të kësaj komponente këtë vit është përcjellë kultivimi i mëllagës te 8 fermerë përfitues, të cilët në vjeshtën e vonë të vitit të kaluar kanë mbjell farën e mëllagës së bardhë, mirëpo vonesa në mbjellje që është bërë për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike ka ndikuar në dështimin e mbirjes së farave. Për këtë arsye fermerët janë furnizuar në pranverë me fara tjera nga kompania kontraktuese dhe është bërë mbjellja e farave në lehë dhe përgatitja e fidanëve të mëllagës së bardhë. Në përgjithësi fushat e mbjella me mëllagë të bardhë janë zhvilluar mirë dhe disa nga fermerët kanë vjelë një pjesë të vogël të gjetheve, ndërsa vitin e ardhshëm do të vjellën rrënjët, e që janë prodhimi kryesor për të cilat janë kultivuar.



Gjatë këtij viti janë përkrahur edhe 10 fermerë me farëra të mëllagës së zezë dhe impute tjera përcjellëse si dhe me nga një serrë me sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup> për tharjen e bimëve përkatësisht luleve të mëllagës së zezë. Fermerët e përzgjedhur për kultivim të kësaj bime janë nga 5 komuna të Kosovës dhe atë në Vushtrri -2, Podujevë -2, Drenas -1, Klinë -2, Istog -1 dhe Skënderaj -2 fermer. Kultivimi i kësaj bime është bërë përmes fidanëve të cilat vetë fermerët i kanë prodhuar në lehë të përgatitura me dheun e shkrifët dhe me pleh të djegur të stallës. Këto fusha me mëllagë të zezë 8 prej të cilave kanë pasur sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> dhe 2 prej tyre nga 500 m<sup>2</sup>, kanë dhënë një prodhimtari të mirë të luleve. Sasia e tërësishme e luleve të vjelura (të thara) e 10 përfituesve nga sipërfaqja e përgjithshme prej 0.90 ha e kultivimit të mëllagës së zezë ka dhënë një prodhim prej 835 kg, të cilat janë plasuar me një çmim prej 10 €/kg, dhe të hyrat e tërësishme janë 8350 €.



Nga bimët tjera aromatike IADK në këtë vit ka përkrahur fermerët edhe në kultivimin e Rigonit të bardhë, ku 5 fermerë përfitues për kultivim të kësaj bime janë furnizuar me fidane të rignonit të bardhë për mbjellje të ngastrave me sipërfaqeve prej 2000 m<sup>2</sup>, pastaj me sistem

të ujitjes pikë-pikë dhe me nga një serrë prej 50 m<sup>2</sup> me konstruksion nga metali i zinkuar dhe mbulesë speciale nga plasmasi për terjen e bimëve pas korrijes. Fermerët përfitues janë nga Komuna e Istogut -4 dhe Mitrovicës-1. Mbjellja e fidanëve është realizuar në gjysmën e dytë të tetorit dhe në përgjithësi fidanët janë zënë mirë dhe në vitin e ardhshëm pritet një zhvillim i mirë i tyre dhe fermerët të bëjnë së paku dy kositje të bimëve, ndërsa kjo bimë është shumëvjeçare dhe do të shfrytëzohet për 5-7 vite.

### **Prodhimtaria e integruar e pemëve dhe perimeve**

Në kuadër të këtij aktiviteti janë formuar dy grupe të fermerëve me nga 15 veta nga regjioni i Mitrovicës për të marrë njohuri në aplikimin e prodhimitarisë së integruar të pemëve dhe perimeve, si dhe kanë aplikuar këto teknika në pemishtet dhe serrat e tyre. Kryesisht janë përfshirë fermerë që kanë pemishte dhe serra, të cilët kanë qenë të interesuar për të përcjellë trajnimet në këtë lëmi. Për të gjithë këta fermerë së pari janë marrë mostrat e dheut nga pemishtet dhe serrat e tyre, me qëllim të kryerjes së analizave për plleshmërinë e tokës, në bazë të së cilave janë dhënë edhe rekomandimet për sasi të nevojshme të plehërimit të tokës. Po ashtu fermerët përfitues janë përkrahur edhe me pompa stërpikës të krahut, rroba mbrojtëse për përdorim gjatë trajtimit të bimëve, kurthe me feromone dhe me disa preparate të lejuara, për trajtim të bimëve në prodhimitarinë e integruar. Të dy grupet e fermerëve kanë përcjellur 10 trajnime për prodhimitarinë e

integruar të pemëve/perimeve, dhe janë vizituar së paku njëherë në muaj gjatë vegjetacionit nga ekspertët përgjegjës të hortikulturës, për të monitoruar gjendjen e bimëve dhe përcaktuar momentin më të përshtatshëm për luftimin e dëmtuesve. Për të parë përvojat e fermerëve në regjion në menaxhimin e integruar të dëmtuesve IADK ka



organizuar nga një vizitë treditore me grupin e perimtarëve dhe pemëtarëve në Shqipëri, ku janë marrë disa përvoja të rëndësishme në kultivimin dhe mbrojtjen e bimëve. Për të përcaktuar momentin më të përshtatshëm për luftimin e dëmtuesve sidomos në pemishte janë shfrytëzuar të dhënat nga stacionet meteorologjike të vendosura në vitin e kaluar në pemishte, dhe trajtimi në momentin e duhur ka bërë që të mos bëhen trajtime të shumta 7-8 trajtime si viteve të mëparshme por kanë bërë 4-5 trajtime, ndërsa në perimet në serra 1-2 trajtime.

### **Kultivimi i dredhëzës mjedrës dhe manaferrës**

Edhe këtë vit janë përkrahur fermerët nga komuniteti serb në kultivimin e frutave të imëta, si janë dredhëza, mjedra dhe manaferra.



Në komunën e Zveçanit dhe të Leposaviqit janë përkrahur 8 fermerë në kultivimin e dredhëzës, të cilët janë furnizuar me fidanë të dredhëzës për mbjellje të sipërfaqeve prej 1000 m<sup>2</sup>, si dhe me impute tjera përcjellëse. Të gjithë fermerët kanë bërë përgatitjet me kohë të tokës, ndërsa mbjellja e fidanëve është bërë në muajin gusht dhe bimët kanë pasur një zhvillim të mirë dhe pritjet një prodhimtari të lartë e frutave në vitin e ardhshëm.




Në komunën Zubin Potok -ut janë përkrahur 3 fermerë me fidane të mjedrës për mbjellje të sipërfaqeve prej 1000 m<sup>2</sup> dhe 2 fermerë me fidanë të mjedrës dhe manaferrës të cilët kanë mbjellë nga 500 m<sup>2</sup> me mjedër dhe 500 m<sup>2</sup> me manaferrë. Po ashtu janë furnizuar edhe me të gjitha inputet dhe pajisjet tjera përcjellëse.

Të gjithë fermerët e përfshirë në këto projekte janë trajnuar dhe këshilluar në teren nga ekspertët e IADK-së, për të gjitha teknikat e kultivimit të këtyre bimëve, si dhe janë bërë dy vizita të përbashkëta të fermerëve shqiptarë dhe serbë në Komunën e Skenderajt ndërsa vizita tjetër është realizuar në Komunën e Shtërpçës.

Një aktivitet tjetër për komunitetin serbë që është realizuar këtë vit është edhe ngritja e një pike grumbulluese të frutave malore. Fermeri përfitues është nga pjesa veriore përkatësisht nga Komuna e Zveçanit, i cili është furnizuar me makinë tharëse të bimëve malore, makinë prerëse të kërpudhave dhe makinë prerëse të mollave të egra. Kjo pikë do të ndikojë në nxitjen e banorëve të zonave malore për të shfrytëzuar potencialet natyrore të kësaj pjese dhe krijimin e të hyrave për ekonomitë familjare.

### Stacionet meteorologjike

Shfrytëzimi i të dhënave nga stacionet meteorologjike për prognozimin dhe sinjalizimin e sëmundjeve në kulturat bujqësore e sidomos në pemishte ka pasur një ndikim shumë pozitiv dhe lehtësues për ekspertët e hortikulturës dhe për fermerët ngase më saktë është përcaktuar momenti më i përshtatshëm i trajtimit të bimëve me preparate mbrojtëse kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Luftimi



në momentin e duhur i dëmtuesve ka bërë që të rritet efekti i preparateve mbrojtëse, të zvogëlohet numri i trajtimeve kimike e me këtë ulja e kostos për mbrojtje të bimëve, si dhe prodhimi i frutave në sasi dhe cilësi të jetë më i lartë.



### Promovimi i energjisë alternative

Një risi në kuadër të aktiviteteve dhe projekteve të shumta që IADK ka realizuar në sektorë të ndryshëm të bujqësisë dhe përpunimit të produkteve bujqësore, është promovimi i energjisë alternative në bujqësi për të ulë shpenzimet e në fermat bujqësore dhe qendrat përpunuese të prodhimeve bujqësore. IADK gjatë vitit 2013 ka angazhuar një ekspertë nga Gjermania për të bërë studimin e fizibilitetit për përdorimin e energjisë alternative në fushat e bujqësisë, dhe në bazë të këtij studimi janë zhvilluar aktivitetet për promovimin e energjisë alternative, të cilat janë të fokusuara në uljen e shpenzimeve gjatë procesit të pasterizimit të qumështit, pasterizimit të perimeve, uljen e shpenzimeve për ujitjen e kulturave bujqësore dhe tharjes së frutave.

### Pasterizimi i qumështit

Në qumështoren “ALDI” e cila gjendet në fshatin Frashër të Mitrovicës është bërë instalimi i paneleve solare dhe pajisjeve tjera përcjellëse me qëllim të ngrohjes së ujit për pasterizim të qumështit. Sipërfaqja e panele të vendosura për këtë qëllim përfshinë një sipërfaqe prej 80 m<sup>2</sup>. Ky instalim i bërë në këtë



qumështore do të shërbejë si pikë promovuese e shfrytëzimit të energjisë alternative përkatësisht asaj solare në industrinë e qumështit, ngase ky projekt përveç që zvogëlon shpenzimet në procesin e pasterizimit

të qumështit, ka edhe rol të rëndësishëm në mbrojtjen e ambientit, ngase eviton nevojën e përdorimit të një pjese të madhe të lëndëve tjera djegëse që përdoren për ngrohjen e ujit për pasterizim të qumështit. Ky fakt është vërtetuar edhe nga vetë pronari i kësaj qumështoreje që është përfitues i këtij investimi, i cili ka bërë kalkulimet e shpenzimeve para dhe pas instalimit të paneleve solare dhe ka konstatuar se për 30 % janë zvogëluar shpenzimet për ngrohjen e ujit për pasterizimin e qumështit.

### Pasterizimi i perimeve

Një investim i ngjashëm sikurse ai në qumështore është bërë edhe në një pikë grumbulluese dhe konservuese të perimeve në fshatin Vërbovc të Drenasit. Në këtë mini-fabrikë të konservimit të perimeve janë instaluar panelet solare në sipërfaqe prej 15 m<sup>2</sup>, si dhe pajisjet tjera përcjellëse për funksionalizim dhe



shfrytëzim të energjisë diellore për ngrohjen e ujit për pasterizim të perimeve. Edhe këtu shfrytëzimi i energjisë diellore ka ulë shpenzimet për 20-30 % , me rastin e ngrohjes së ujit në procesin e pasterizimit të perimeve përkatësisht pasterizimin e kavanozave me perime të konservuara.

### Tharëset solare

Për të promovuar energjinë solare në një fushë tjetër të bujqësisë përkatësisht në bimët malore dhe frutat tjerë, janë përkrahur edhe dy fermer grumbullues të bimëve mjekësore dhe frutave malore me nga një furrë tharëse të frutave, të cilat shfrytëzojnë energjinë diellore për tharjen e bimëve. Njëri fermer përfitues është nga Skënderaj ndërsa tjetri nga Artana, dhe kanë përfituar



tharëset solare me kapacitet për tharjen ditore të 70 kg të frutave, ndërsa përveç tharëseve kanë marrë edhe disa pajisje tjera për paketim të produkteve të thara.

### Pompat solare

Ujitja e kulturave bujqësore është një nga faktorët kyç dhe të domosdoshëm për të arritur prodhimtari të lartë dhe cilësore të bimëve. Për të evituar shpenzimet në ujitjen e bimëve IADK në këtë vit ka përkrahur tre fermerë (Vushtrri-1, Podujevë-1, dhe Zubin Potok-1) me pompa për ujitje të cilat vihen në lëvizje përmes energjisë solare. Për funksionim të pompave janë vendosur panelet solare dhe pajisjet tjera përcjellëse, dhe kapaciteti ditore i këtyre pompave është nga 20-30 mijë litra uji, në varësi edhe të thellësisë së ujit, pjerrtësisë së terrenit që duhet të dërgohet uji dhe intensitetit të ndriçimit të diellit. Në bazë të kalkulimit të fermerëve përfitues të këtyre pompave është konstatuar se shfrytëzimi i këtyre pompave për secilin fermerë do të ulë për 500-1000 €, shpenzimet për ujitjen e kulturave bujqësore-perimeve.



### Ngritja e serrave për prodhimin e perimeve

Në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja “Promovimi shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës” janë realizuar edhe disa projekte në sektorin e hortikulturës, si janë: ngritja e serrave dhe pemishteve. Në fshatin Bajgorë janë përkrahur 3 fermerë në ngritjen e serrave me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, në Sllakovc 2 fermer dhe në Gumnishtë 1 fermerë. Të gjithë këta përfitues përveç

serrës kanë marrë edhe inputet përcjellëse. Përfituesit nga ky aktivitet kanë mbjellë tri kultura të perimeve: speca, domate dhe tranguj. Gjatë vegjetacionit janë mbajtur trajnime dhe këshilla praktike në kultivimin e perimeve në serra, si dhe është organizuar një vizitë lokale me përfituesit të disa serra më të avancuara për të parë përvojat e fermerëve tjerë në kultivimin e perimeve në serra. Në përgjithësi fermerët kanë arritur të kenë prodhimtari mesatarisht të kënaqshme të perimeve e me cilësi të mirë, dhe janë prodhuar nga të gjashtë përfituesit 9865kg perime të freskëta, që do të thotë se mesatarisht secili fermer ka marrë nga 1644kg perime.



### **Ruajtja dhe përtëritja e varieteteve tradicionale të pemëve**

Ky aktivitet u ka dhënë mundësinë fermerëve të zonës së Shalës që të përfitojnë nga ngritja e pemishteve me mollë dhe dardhë me varietete tradicionale. Një fermerë nga fshati Bajgorë është përkrahur në ngritjen e pemishteve me mollë me kultivar tradicional, në sipërfaqe prej 0.20 ha, ndërsa 2 fermerë tjerë në fshatin

Skromë janë përkrahur në ngritjen e pemishteve me dardha me kultivar po ashtu tradicional dhe në sipërfaqe prej 0.20 ha. Përfituesit përveç fidanëve kanë marrë edhe plehrat minerale, pako të pesticideve, pompe stërpikës krahu, gërrshërë për krasitje, sistemin e ujitjes pikë-pikë, shtylla betoni dhe tel për rrethojë të pemishteve. Po ashtu për fermerët janë mbajtur trajnime dhe këshilla praktike për teknikat e ngritjes së pemishteve dhe masat e përkujdesit pas ngritjes së pemishteve.

### **Ngritja e pemishteve me mjedër dhe manaferrë**

Nga ky aktivitet janë përkrahur 4 fermerë në ngritjen e pemishteve me mjedër dhe manaferrë në sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup> (secili fermer ka mbjellë nga 500 m<sup>2</sup> me mjedër dhe 500 m<sup>2</sup> me manaferrë). Nga një pemishte e tillë është ngritur në fshatin Bare, Bajgorë, Skromë dhe Sllakovc, dhe fermerët janë furnizuar me fidanë të mjedrës e manaferrës dhe me inpute si dhe janë organizuar trajnime dhe këshilla teknike në përgatitjen e tokës, mbjelljen e fidanëve dhe masat tjera të përkujdesit ndaj bimëve. Si rezultat final janë ngritur katër pemishte me nga 0.10/ha me fruta të imëta.



### Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitet të Fermave –RrDhKF (FADN)

IADK është kontraktuar nga MBPZHR për grumbullimin e të dhënave e të dhënave nga 400 ferma të Kosovës. IADK ka lehtësuar punën e stafit të Ministrisë në sigurimin e mostrës e cila ka qenë e paraparë për 400 fermer në nivel vendi.

Nga një projekt i binjakëzimit në MBPZHR, është organizuar një trajnim 5 ditorë për stafin e IADK-së të përfshirë në grumbullimin e të dhënave nga fermat, e që kanë marrë pjesë edhe disa zyrtarë të Ministrisë së Bujqësisë, ku janë përfituar njohuri në plotësimin e pyetësorit “**LIBRI I FERMËS**” Për grumbullimin e të dhënave për FADN”. Ky libër është shoqëruar edhe me Manualin për shfrytëzimin e pyetësorit. 13 ekspert të IADK kanë qenë të përfshirë në grumbullimin e të dhënave dhe futjen e tyre në softuerin për FADN.

### Mbajta e trajnimeve teknike dhe ekonomike në Qendrën për grumbullimin, rritjen dhe përpunimin e bimëve mjekësore dhe kërpudhave

IADK është kontraktuar për organizimin dhe mbajtjen e trajnimeve në promovimin e kultivimit të bimëve mjekësore dhe kërpudhave me fermerë nga komuna e Skënderajt dhe Vushtrrisë. Projekti ka qenë i mbështetur nga EURED – i, ndërsa është implementuar nga komuna e Skënderajt në partneritet me Komunën e Vushtrrisë. Trajnimet që janë mbajtur deri më tani kanë qenë të natyrës teknike ku janë prezantuar kultivimi organik i bimëve mjekësore, teknologjitë e kultivimit, ruajtjes, tharjes si dhe llogaritja e shpenzimeve të prodhimit. Në këtë vit janë mbajtur gjashtë trajnime, ndërsa në vitin 2014 do të mbahen edhe katër trajnime tjera.

## ORGANIZIMI I FERMERËVE

Në kuadër të projektit “Edukimi dhe Konsolidimi i Fermerëve në Kosovë 2012-2014 “ një komponentë mjaftë e rëndësishme ka qenë edhe përkrahja e fermerëve dhe shoqatave të tyre në një organizim të përbashkët, me qëllim të përfaqësimit dhe dëgjimit të zërit të tyre në organet dhe institucionet vendim marrëse për sektorin e bujqësisë, si dhe të mundësohet përfaqësimi dhe pjesëmarrja në organizimet e bujqësisë në rrjetet ballkanike dhe evropiane. Disa nga këto aktivitete kanë filluar në vitin e kaluar, ndërsa për arritjen e këtij objektiv IADK ka organizuar edhe gjatë këtij viti shumë



takime dhe punëtori, ndër të cilat së pari është mbajtur **Punëtorja për finalizimin e procesit të krijimit të shoqatës së fermerëve në nivel vendi**, ku fermerët dhe përfaqësues të disa shoqatave ekzistuese nga gjithë Kosova kanë formuar një grup prej 15 anëtarëve, të cilët më pastaj në mbështetje të IADK-së kanë udhëheqë punët në procesin e themelimit të shoqatës së fermerëve në nivel të Kosovës. Duke pasur parasysh se një organizim i më hershëm i fermerëve në



shoqata të ndryshme ka ekzistuar në baza sektoriale dhe ata kanë pasur të themeluar edhe shoqata në nivel të Kosovës, si ishte rasti me prodhuesit e qumështit, shpezëve, bletarëve, dy unione të shoqatave në nivel regional etj., ndërsa ka munguar një organizim i tillë në sektorin e pemëve dhe perimeve, dhe për këtë arsye IADK ka përkrahur fermerët përkatësisht shoqatat lokale në këta dy sektorë që të themelojnë shoqatën e kultivuesve të perimeve e njohur si Unioni i Prodhuesve të Perimeve në Kosovë (UPPK) dhe atë të kultivuesve të pemëve e njohur si Asociacioni i Pemëtarëve të Kosovës (ASPEK), të cilat do të jenë pjesë përbërëse e shoqatës së fermerëve të Kosovës.



Nën organizimin e grupit të lartcekur punues dhe asistimin e IADK-së më 6 Prill 2013 është mbajtur kuvendi zgjedhor i për themelimin e organizatës së fermerëve në nivel të Kosovës, në të cilën morën pjesë 40 pjesëmarrës (fermerë dhe përfaqësues të shoqatave nga sektorë të ndryshëm të bujqësisë). Kuvendi vendosi që organizata e fermerëve të Kosovës të quhet **BASHKIMI I SHOQATAVE BUJQËSORE TË KOSOVES (BSHBK)**. Në këtë organizatë janë të përfaqësuar fermerët përkatësisht shoqatat e fermerëve nga gjithë Kosova të sektorëve të ndryshëm të bujqësisë si ai: i qumështi, shpezëve, pemëve, perimeve, bletarisë, deleve e dhive, bimëve aromatike mjekësore, përpunimit shtëpiak të ushqimit, verës si dhe dy unione regjionale të shoqatave të fermerëve (Rrjeti “Agrodukagjini” dhe Unioni i Shoqatave të Fermerëve të Regjionit të Mitrovicës-USHFRM). Kryetar i BSHBK-së u zgjodh z. Agim Sahiti i cili njëkohësisht është edhe kryetar i Shoqatës së Shpendtarëve dhe Prodhimeve të Ushqimit të Kafshëve të Kosovës. **Bordi drejtues i BSHBK-së** është i përbërë nga 11 anëtarë të cilët vijnë nga shoqatat anëtare të BSHBK-së. Në muajin gusht BSHBK është regjistruar zyrtarisht në Ministrinë e Shërbimeve Publike. Zyra e kësaj shoqate është në Prishtinë, e cila është pajisur me inventar dhe kompjuter nga IADK, e cila për një vit do të mbulojë edhe shpenzimet e qirasë së zyrës. IADK për të fuqizuar strukturat udhëheqëse të Bashkimit të Shoqatave Bujqësore të Kosovës gjegjësisht bordi i BSHBK-së ( 11 anëtarët) gjatë vitit ka organizuar tetë sesione të trajnimeve në aspektin menaxherial, si dhe trajnime në aspektin bujqësor dhe juridik.

Po ashtu një mision një javor i një eksperti nga Gjermania është financuar nga IADK, për të sjellë përvoja të strukturat udhëheqëse të BSHBK-së, ku janë diskutuar tri çështje si janë: Qëndrueshmëria financiare e BSHBK-se , Anëtarësia dhe Marketingu.

Me qëllim të njohjes me formën organizimit në nivel nacional të fermerëve në Maqedoni dhe në Francë nga baza deri në nivelin më të lartë, mënyra e menaxhimit, qëndrueshmëria, lobimi dhe të gjitha çështjet tjera që janë të lidhur



me organizimin e fermerëve, IADK ka për bordin e BSHPK-së ka organizuar dy vizita studimore.

## DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TE USHQIMIT

### Trajnimet ne përpunim shtëpiak, produkte te orientuara për treg (perime, fruta dhe djathë)

#### Trajnimet ne modulën e qumështit

Në këtë grup janë trajnuar 15 gra nga komuna e Prishtinës. Posedimi i lëndës së parë - qumështit për përpunim si dhe orientimi për treg kanë qenë kriteret kryesore për përzgjedhjen e këtyre kandidatëve për këtë modul.



Ky modul ka përmbajtur 20 sesione ku gratë janë trajnuar në prodhimin e 5 llojeve të ndryshme të djathit dhe 5 sesione të trajnimeve në aspektin ekonomik. Nga ky grup 8 gra kanë filluar shitjen e prodhimeve të tyre me vlerë prej 4,060.50 €

#### Trajnimet në modulën e pemëve

20 sesione të trajnimeve në modulën e pemëve dhe 5 sesione të trajnimeve në aspektin ekonomik janë mbajtur në Fshatin Bradash të Komunës së Podujevës. Gjatë këtyre trajnimeve gratë janë aftësuar në përpunimin e xhemëve dhe reçelrave të ndryshëm nga peme të ndryshme. Disa trajnime praktike janë mbajtur në pikën përpunuese në fshatin Broboniq të komunës së Mitrovicës, e cila shërben edhe si pikë demonstruese për grupet e grave. Pas përfundimit të trajnimeve IADK këtë grup të grave e ka përkrahur në krijimin e shoqatës së grave "Tradita e jonë".

#### Trajnime në modulën e perimeve

Trajnimet në modulën e perimeve janë organizuar në fshatin Druvar të komunës së Vushtrisë dhe në fshatin Bajgorë të komunës së Mitrovicës, ku kanë marrë pjesë 29 kandidatë të cilat janë aftësuar në përpunimin e llojeve të ndryshme të turshive në bazë të kërkesave të tregut. Me datën, 13 Dhjetor 2013 u mbajt ngjarja "Certifikimi i grupeve të grave dhe fermerëve" ku 55 gra nga këto 3 grupe janë certifikuar për përfundimin me sukses të këtyre trajnimeve.



### Trajnimi i grave ne aspektin ekonomik te prodhimit/përpunimit

Keto grupe te grave te cilat kane kryer trajnime ne tri modulet sic jane moduli i qumështit, i perimeve dhe pemëve kane vazhduar ne ndjekjen edhe te 5 sesioneve te trajnimeve ekonomike lidhur me biznesin, ne mbajtjen e shënimeve, menaxhimi i fermës, kalkulimin e shpenzimeve, marketing dhe promovim te produktit

Pjesëmarrëset e trajnimeve te cilat kane filluar te përpunojnë produkte për treg kane filluar mbajtjen e shënimeve si dhe kalkulimin e koston se prodhimit. Po ashtu kane filluar te përdorin etiketa si pjese te promovimit te produktit.

Ne fund te vitit respektivisht me me datën, 13 Dhjetor 2013 u mbajt ngjarja “Certifikimi i grupeve të grave dhe fermerëve” ku 55 gra nga këto 3 grupe jane certifikuar për përfundimin me sukses te këtyre trajnimeve.

### Trajnimet ne aspektin e shërbimeve turistike për familjet mikpritëse dhe restorantet

Në mënyrë që të aftësohen familjet mikpritëse dhe restorantet në zonën e Shalës në shërbimet e turizmit janë planifikuar mbajtja e trajnimeve me temat si në vijim: tërheqja vizitorëve, marketingu shërbimet e ofruara; organizimi dhe menaxhimi; shërbimi vizitorëve me ushqime tradicionale. Nga 6 seanca trajnimi që janë mbajtur kanë marrë pjesë -45 pjesëmarrës (kuzhinier të restoranteve, gra nga familjet mirëpritëse pronar të odate).

### Edukimi dhe trajnimi i grave në përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit

Me qëllim të aftësimit të grave të kësaj zone për përgatitjen e ushqimit tradicionale me receptura të standardizuara si dhe lidhjes se tyre me restorantet e kësaj zone janë organizuar 30 sesione të trajnimeve në modulin e brumit.

Gjate ceremonisë së promovimit të projektit ky grup i grave janë përzgjedhur nga restoranti “Lumi Trofta “ për përgatitjen e ushqimit tradicional, ushqim të cilën kane praktikuar gjatë trajnimeve në modulin e brumit.

Poashtu kanë marrë pjesë në Ditën Ndërkombëtare të Gruas Rurale dhe panairë të ndryshme.

### Promovimi i produkteve

IADK ka vazhduar me organizimin e pikës degustuese dhe promovuese në qendrën tregtare VIVA FRESH”. Promovimi është bërë gjatë muajit Mars . Po ashtu është përgatitur forma e vlerësimit ku konsumatorët gjatë degustimit të produkteve kanë dhënë vlerësimet e tyre. Edhe pse kjo ngjarje nuk është planifikuar për shitje të produkteve me insistimin e konsumatorëve është bërë edhe shitja e produkteve në vlerë prej 1,402.00 euro.



Duke e parë që tregu është ndër hallkat më të rëndësishëm në procesin e punës, IADK ka hapur pikën promovuese në Prishtinë me moto **“Shijo produkte të shëndetshme dhe tradicionale”** e cila pikë gjendet në lagjen Pejton në rrugën “Lidhja e Prizrenit nr.10. Qëllimi i krijimit të kësaj pike është promovimi dhe krijimi i lidhjeve në mes fermerëve, grave përpunuese dhe konsumatorëve.

Po ashtu si pjesë të promovimit të produkteve është pjesëmarrja në panairë të ndryshme ku IADK ka organizuar panairin për nder të 8 Marsit festës së gruas ku kanë marrë pjesë 31 pjesëmarrëse.

Po ashtu IADK ka përkrahur gratë për pjesëmarrje në këto panairë

1. Panairi i trashëgimisë kulturore e organizuar nga SHG “Dera e Hapur” Prishtinë – Shtator 2013
2. Panairi i produkteve bujqësore-MBPZHR dhe OEK
3. Panairi “Agrokos” – CeoKos
4. Panairi regional “ Mitrovica 2013-



Është bërë njoftim në radion lokale “Radio Drenica” për promovimin e produkteve të grave.

### **Krijimi i pikës përpunuese për peme dhe perime**

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve përpunuese të pemëve dhe perimeve dhe fuqizimit të gruas, në fshatin Frashër të komunës së Mitrovicës është krijuar pika përpunuese e perimeve ku IADK ka përkrahur në rregullimin e kësaj pike si dhe pajisjet për këtë pikë përpunuese. Pronarja e kësaj pike përpunuese ka filluar me prodhimin e 14 llojeve të ndryshme të produkteve si dhe ka filluar me shitjen e këtyre prodhimeve ku deri më tani ka bërë shitje në vlerë prej 12,737.65 €.

### **Tryeze e rrumbullakët me të gjithë partneret në zinxhirin e vlerave për ushqimin e përpunuar shtëpiak**

Gjate muajit Maj IADK ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temë "Krijimi i bashkëpunimit në mes të aktorëve të zinxhirit të vlerave në sektorin e përpunimit të produkteve tradicionale"

Në këtë tryeze kanë marrë pjesë 24 pjesëmarrës nga të gjitha palët e interesit, prodhues të pemëve dhe perimeve, përpunuesit e ushqimit, tregtarë dhe konsumator.

### **Përcjellja e të gjitha njësive të themeluara të përpunimit: organizimin e trajnimeve shtesë dhe avancimin**

Edhe gjatë këtij viti grupet e grave dhe pronaret e 5 pikave përpunuese të themeluar nga IADK gjatë viteve 2009-2012 veçanërisht ato të cilat prodhojnë

për treg janë përcjellur dhe përkrahur në zhvillimin e biznesit të tyre. Pikat përpunuese dhe gratë aktive në treg kanë zhvilluar aktivitetet e tyre ku gjatë sezonës së shitjes kanë bërë shitje në vlerë prej 29,627.00 €

### **Përmirësimi i kualitetit të prodhimeve dhe standardizimi**

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të prodhimeve të grave si dhe standardizimit të tyre në vitin 2013 janë zhvilluar këto aktivitete

a) Misioni i konsulatantes nga Holanda i cili mision është realizuar gjatë muajit Qershor. Qëllimi i kësaj vizite ishte fokusuar në tri çështje:

- Trajnime për grupet e grave në standardizimin e produktit
- Ngritja e kapaciteteve të departamentit të stafit të përpunimit IADK
- seminar në sektorin e përpunimit shtëpiak me organizata të grave për njohjen sa më të mirë me rregullat e standardizimit .

b) Në muajin korrik është mbajtur kuvendi i përgjithshëm i Ombrelles së shoqatave të grave të cilat mirren me përpunimin shtëpiak ku kanë marrë pjesë 14 shoqata të grave nga e gjithë Kosova. Në kuvend është bërë zgjedhja e bordit dhe kryesisë së kësaj ombrelle ku kryetare u zgjodh znj, Valbona Kelmendi nga shoqata “ Kelmendi” nga Fshati Lipe komuna e Zvecanit.

### **Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi ekonomik i grave kryefamiljare**

Njëra nga synimet e IADK-se është fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës.

Nga komuna e Vushtrisë 3 gra janë përkrahur për të aplikuar në komunën e Vushtrisë për përfitimin e serrave ku IADK ka përkrah këto gra në pagesën e bashkëfinancimit në vlerë prej 300€.

Po ashtu në bashkëpunim me komunën e Drenasit IADK në fund të vitit 2013 ka përkrahur 4 gra të komunës së Drenasit me pajisje të nevojshme për krijimin e një pike për përgatitjen e ushqimeve për nxënësit e shkollës fillore “Rasim Kiqina”.



Është organizuar një takim i grave të veja të komunës së Vushtrisë me zyrtarët për barazi gjinore pranë kuvendit komunal . Gjatë këtij takimi gratë e kanë paraqitur problemet dhe hallet me të cilat ballafaqohen. Një ndër temat e diskutuar në këtë takim ishte përkrahja e fëmijëve të këtyre grave për ndarje të bursave për shkollim. Si rezultat i këtij takimi, 7 fëmijëve iu janë ndarë bursa.

### **Bashkëpunimi me RrGGK dhe partneret tjerë në Kosovë**

Në vazhden e bashkëpunimit në mes të RrGGK –së dhe IADK janë organizuar 6 sesione të trajnimeve në aspektin shëndetësor me temë ” Kanceri i gjirit dhe mitrës”, pasi edhe ka qenë muaji i luftës kundër kancerit, ku kanë marrë pjesë 79

gra nga grupe të ndryshme të grave si dhe gra të veja nga komuna e Vushtrrisë. Këto trajnime janë mbajtur nga shoqata “Dera e Hapur” e cila shoqatë është anëtare e RrGGK-së.

### **Bashkëpunimi në mes të IADK-se dhe Odës Ekonomike të Kosovës**

Gjate vitit 2013, IADK ka bashkëpunuar me Odën Ekonomike të Kosovës – OEK përmes projektit “Programi për fuqizimin e grave në sektorin e agrobiznesit në zonat rurale përmes OEK për një ekonomi formale të qëndrueshme”. IADK ka kryer shërbime, trajnime në aspektin e zhvillimit të produktit respektivisht trajnime në përpunimin e pemëve dhe perimeve, higjienës, ruajtjes së produktit, zingjirit të vlerës, kostos së prodhimit për grupin e grave në kuadër të shoqatës së grave” Alba” nga fshati Prugovc, komuna Prishtinë.



### **FUQIZIMI I KAPACITETIT TË SHOQËRISË CIVILE PËR POLITIKËBËRJE DHE KONSULTIM ME QEVERINË NË SEKTORIN E BUJQËSISË**

Projekti për shoqëri civile “Fuqizimi i kapacitetit të shoqërisë civile për politikebërje dhe konsultim me Qeverinë në sektorin e bujqësisë”, është një projekt i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe implementohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK) në partneritet me Syri i Vizionit (SiV). Projekti ka filluar në dhjetor 2012 dhe kohëzgjatja e projektit është 24 muaj, me një buxhet prej 0.22 mil EUR (94.09% financuar nga ZBEK në bashkëfinancim me IADK dhe MBPZHR me 5.91%).



Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është mundësia e dialogut dhe konsultimeve permanente në politikebërje dhe vendimmarrje në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile në sektorin e bujqësisë. Tri komponentët kryesorë të projektit janë:

1. Ndërtimin e Kapaciteteve të organizatës së fermerëve në nivel nacional.
2. Promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit në mes të institucioneve bujqësore dhe organizatës së fermerëve në nivel nacional.



3. Përfshirja e Organizatës Nacionale të Fermerëve në rrjetet rajonale si dhe iniciativa për përfshirjen e kësaj organizate në organet e komunitetit Evropian.

Grupi i synuar (cak) i këtij projekti janë anëtarët e Organizatës Nacionale të Fermerëve (101 organizata të fermerëve, kooperativa, shoqata), organizatat rurale të grave dhe organizatat e të rinjve.

### **Trajnimet ne Avokim dhe Aftësi Komunikuese**

Për shumë vite fermerët në Kosovë janë përballur me shumë vështirësi në të bërit biznes. Pavarësisht situatës së pa qëndrueshme ekonomike, fermerët janë përballur me vështirësi në menaxhimin e biznesit e po ashtu edhe komunikim dhe përgatitje të raporteve, në organizimin dhe zhvillimin e strategjive dhe në krijimin e kushteve më të mira për të bërë biznes. Prandaj, organizimi dhe mbajta e këtyre trajnimeve është konsideruar si një nevojë, për tejkalimin e sfidave të sipërpërmendura. Ky aktivitet është realizuar në dy raunde të trajnimeve:

1. **Trajnimet në Aftësitë Komunikuese:** aftësitë komunikuese, negociuese, prezantuese, aftësitë ndikuese dhe mbajtja e takimeve.
2. **Trajnimet ne Avokim dhe Lobim:** analiza e situatës, avokimi, struktura e shtetit dhe fuqisë së aleancave, lobimi, kampanja mediale dhe zhvillimi dhe implementimi i strategjive.

**Aftësitë Komunikuese:** këto trajnime janë mbajtur në 6 sesione në 3 grupe me nga 15 pjesëmarrës për grup. Trajnimet janë zhvilluar në 18 ditë të trajnimeve dhe kanë marrë pjesë 65 fermer, ku si rezultat janë certifikuar 23 pjesëmarrës, të cilët kanë pasur një prezencë prej 80% në trajnime. Pjesëmarrës kanë qenë 22 shoqata të fermerëve nga 19 komuna të ndryshme të Kosovës.

**Trajnimet në Avokim dhe Lobim:** këto trajnime janë mbajtur në 6 sesione në 3 grupe me nga 15 pjesëmarrës për grup në mënyrë që të bëhet një trajnim më efektiv. Për dallim nga trajnimet e kaluara, këto trajnime janë mbajtur në 3 regjione të ndryshme të Kosovës, si në Prishtinë, Prizren dhe Pejë. Arsyeja e mbajtjes së trajnimeve në lokacione të ndryshme është bërë në mënyrë që të jemi më afër fermerëve duke bërë që t’ju zvogëlohen shpenzimet e udhëtimit nga regjionet e ndryshme për të ardhur në Prishtinë, e mbi të gjitha për të përmirësuar apo për të pasur një pjesëmarrje më të lartë në trajnime. Këto trajnime janë mbajtur në 18 ditë trajnimi. Pjesëmarrës në trajnime kanë qenë 71 fermer, ku si

rezultat janë certifikuar 37 fermer të cilët kanë pasur një prezencë prej 80% në trajnime. Pjesëmarrës kanë qenë 31 shoqata të fermerëve nga 19 komuna të ndryshme të Kosovës.

### **Vizita studimore e BSHBK-së në shtetin e Bullgarisë**

Duke marrë në konsideratë se BSHBK-ja është një organizate e re dhe nuk ka eksperience në bashkëpunimet me institucionet dhe organizata të ngjashme, nga data 13-16 Shtator 2013 anëtarët e bordit të BSHBK-së kanë qenë në një vizite studimore në Bullgari. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 5 anëtarë të bordit të

BSHBK-së dhe një anëtar nga SiV, organizatë partnere e projektit të shoqërisë civile. Gjatë kësaj vizite studimore, anëtarët e bordit të BSHBK-së kanë vizituar kompani të prodhimit të bimëve foragjere, kompani për rritjen dhe përpunimin e mishit, kompani për prodhimin e energjisë së ripërtritshme dhe solare, ferma të pularisë dhe përpunimit të mishit, përfaqësues të shoqatës e cila merret me promovimin e produkteve bullgare jashtë vendit dhe përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë së Bullgarisë.



### Gazeta Mujore dhe Ueb faqja e BSHBK-së

Një ndikim të madh në ofrimin e informatave për fermer ka pas publikimi i Gazetës Mujore. Kjo gazetë ofron artikuj të ndryshëm nga sektori i bujqësisë, pastaj aktiviteteve të BSHBK-se dhe tema të tjera në ngritjen e kapaciteteve dhe ofrimin të informacioneve më të reja nga sektori i bujqësisë. Gjatë këtij viti janë publikuar 6 numra të gazetës në tri gjuhë: Shqipe, Serbe dhe Angleze. Secili numër është publikuar në 2000 kopje, në total 12000 kopje.

Numri i parë i gazetës mujore është publikuar në Qershor 2013 në 2,000 kopje në 3 gjuhë. Deri me tani janë publikuar dhe shpërndarë 6 numra të gazetës mujore, me një total prej 12,000 kopje dhe është shpërndarë tek të gjitha palët e interesit në sektorin e bujqësisë.



Po ashtu, është krijuar edhe ueb faqja e BSHBK-së e cila tashme është online në internet ([www.bshbk.net](http://www.bshbk.net)).

### Sigurimi i hapësirës punuese (zyrave) për BSHBK-në


Në kuadër të këtij aktiviteti është bërë e mundur të sigurohet hapësire pune apo zyre për BSHBK-në dhe anëtarët e saj. Këto zyre janë funksionale dhe të pajisura me të gjitha elementet përcjellëse. Zyrat gjenden në lagjen Arbëria në këtë adresë: Rr. Ahmet Krasniqi p.n. Objekti “Gratë për Gratë” në Prishtinë. Këto zyre kanë shërbyer për realizimin e disa aktiviteteve të projektit, duke përfshirë trajnimet për BSHBK-në, grupet punuese me MBPZHR-në dhe ngjarje e aktivitetet të tjera.

### **Punëtoritë regjionale rreth strategjive zhvillimore për ekonomi, bujqësi, ligje dhe rregullore.**

Ndërmjet muajve Maj dhe Gusht 2013 janë organizuar 5 punëtori regjionale në 5 regjionet e Kosovës, në Pejë, Mitrovicë, Prizren, Gjilan dhe Prishtinë. Në këto punëtori kanë marrë pjesë 227 pjesëmarrës nga të gjitha palët e interesit të sektorit të bujqësisë.

Siç shihet në grafikun e më poshtëm, struktura e pjesëmarrësve në këto punëtori ka qenë e ndryshme, duke përfshirë pjesëmarrës nga niveli lokal dhe ai regjional, si organizata nga shoqëria civile, fermer individualë, përfaqësues nga niveli lokal dhe nga MBPZHR. Nga totali i përgjithshëm rreth 12% kanë qenë nga gjinia femërore.

### **Struktura e përfaqësimit të pjesëmarrësve**



### **Konferencën në nivelin qendror për dialogu me MBPZHR-në dhe autoriteteve përkatëse për bashkëpunim**

Si vazhdim i pesë punëtorive regjionale, më datën 31 Tetor 2013 në Prishtinë është mbajtur konferenca në nivelin qendror ku janë paraqitur dhe analizuar të gjeturat nga pesë punëtoritë rajonale me specifikat për secilin regjion dhe mundësitë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në këtë regjione, gjithashtu janë dhënë rekomandime për MBPZHR dhe BSHBK-në, për përmirësimin dhe avancimin e sektorit të bujqësisë. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë më shumë se 50 përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore (komunat, MBPZHR), organizatat e shoqërisë civile (BSHBK, fermer individual, GLV) dhe akter të tjerë nga sektori i bujqësisë në Kosovë.



### **Ofrimi i ekspertizës për BSHBK-në dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme të MBPZHR**

Qëllimi i këtij aktiviteti është rritja e dialogut dhe bashkëpunimit midis shoqërisë civile dhe qeverisë. Prandaj, si rezultat i një dialogu të gjatë në mes të shoqërisë civile nga sektorin e bujqësisë (BSHBK-së) dhe MBPZHR-së, është bërë e mundur që të arrihet nxirrja e udhëzimit administrativ (MF - NO 05/2013) "Për zbatimin e normës së sheshtë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH-së) për

prodhuesit bujqësorë". Rol të madh në këtë proces ka luajtur IADK dhe BSHBK nëpërmjet organizatave brenda saj, përkatësisht Shoqata e Prodhuesve të Qumështit të Kosovës (SHPQK).

Po ashtu në kuadër të këtij aktiviteti janë organizuar 4 Grupeve Punuese (GP) në sektorin e Blegtorisë dhe Hortikulturës, shërbimeve këshillimore me MBPZHR. Në ato GP kanë marrë pjesë 74 përfaqësues nga MBPZHR-ja, Projektit të Binjakëzimit, anëtarë të BSHBK-se, përfaqësues të organizatave jo-qeveritare. Te gjithë GP janë mbajtur në lidhje me zhvillimin e strategjisë për bujqësi Plani i Zhvillimit Rural 2014-2020.



Një Tryeze e rumbullakët është organizuar në mes të shoqërisë civile dhe Qeverisë, me temë "Shërbimet këshillimore dhe roli i tyre në avancimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë". Në këtë takim kane qenë 22 pjesëmarrës nga institucione të ndryshme, përfaqësues të MBPZHR, Odës Ekonomike të Kosovës, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Banka Botërore, Organizata të fermerëve, Grupet Lokale të Veprimt, përfaqësues nga komunat e Gjilanit dhe Lipjan, Ambasadës Norvegjeze në Kosovë, dhe nga DANIDA, IADK, organizata Gratë për Gratë dhe USAID/NOA .

### **Përkrahja e BSHBK-se për anëtarësim në BAAN**

Rrjeti Ballkanik i Shoqatave Bujqësore (BAAN) është një rrjet i OJQ-ve bujqësore në regionin e Ballkanit i themeluar në vitin 2008 me pjesëmarrjen e shteteve të Ballkanit; Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. BAAN është një forum në të cilin përfaqësuesit e Organizatave të fermerëve (FA) të rajonit takohen për të diskutuar dhe ndarë përvojat.

Objektivi i tij i përgjithshëm është që të kontribuojë në drejtim të forcimit të bashkëpunimit në mes të shoqatave të fermerëve të vendeve të Ballkanit dhe fuqizimit të organizatave të fermerëve në nivel kombëtarë, të cilat janë të qeverisur dhe menaxhuar në bazë të parimeve të demokracisë dhe transparencës, të mbështetur në mënyrë aktive me aktivitetet dhe interesat e menjëhershme të anëtarëve të tyre në nivelin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

IADK është një nga themeluesit e BAAN-it dhe është duke bërë të gjitha përpjekjet për të promovuar dhe përkrahur BSHBK-në për t'u bërë anëtare e BAAN-it.

Ky rrjet Ballkanik ka mbajtur mbledhjen vjetore të organizuar në qytetin e Shkodrës në Shqipëri nga data 30 Shtator deri më 2 Tetor 2013. Në këtë konferencë ka marrë pjesë kryetari i BSHBK-së z. Agim Sahiti dhe një përfaqësues nga IADK-ja zonja. Magbule Hyseni.

Pjesëmarrësit diskutuan nevojën e zgjerimit të rrjetit dhe për të tërhequr organizatat e tjera rurale të bashkohen. Për të krijuar një strukturë brenda rrjetit, një grup pune u formua përbërë nga IADK, Federata e Fermerëve të Maqedonisë dhe Agromreza nga Shqipëria. Grupi i punës do të takohet në Kosovë dhe do të vendosë në dy çështje kryesore: kriteret për anëtarësim në BAAN dhe drejtimet e ardhshme të bashkëpunimit. Përfundimi ishte se përgjegjësia (ose “presidenca”) e BAAN-it duhet të jetë në sistem të rotacionit për çdo vit dhe me këtë rast zyrtarisht udhëheqjen e BAAN-it për këtë vit e ka marrë IADK deri më 2 tetor të vitit 2014.

### **Organizimi i Konferencës së Rrjetit Ballkanik për Prodhimtari Organike (BON) në Kosovë**

IADK si anëtare e Rrjetit Ballkanik për Prodhimtari Organike (BON) ka organizuar konferencën e BON-it me titull: “Promovimi i prodhimit organik në Kosovë dhe bashkëpunimit në vendet e Ballkanit”.

Qëllimi i konferencës ishte të mbështesë promovimin e prodhimit organik në Kosovë dhe për të gjetur mundësitë më të mira për bashkëpunim ndërmjet anëtarëve BON-it nga vendet e ndryshme të Ballkanit.

Konferenca u organizua në kuadër të këtij projekti dhe ngjarja u zhvillua në Prishtinë nga data 3-5 Dhjetor 2013. Nga të gjithë anëtarët e BON-it të ftuar nga vendet e Ballkanit, në këtë konferencë morën pjesë 14 përfaqësues nga: Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia dhe Mali i Zi. E ftuar për këtë ngjarje nga vendet e BE-se ishte znj. Anamarija Slabe, këshilltare e lartë e cila përfaqësoi Institutin e Kërkimeve të Bujqësisë Organike (FiBL) nga Zvicra dhe ISD nga Sllovenia.



Përveç anëtarëve BON-it, në konferencë morën pjesë edhe pjesëmarrës vendore, përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) të Kosovës, Fakultetit të Bujqësisë, IADK-se, GIZ-it, Shoqata e Bujqësisë Organike në Kosovë (SHBOK), Bashkimi i Shoqatave Bujqësore të Kosovës (BSHBK), Kompanitë private që merren me prodhimtarinë organike.

**Mbështetja e BSHBK-së në bashkëpunim me organizatat nga vendet e BE-së**  
Ky projekt po përkrahë procesin e anëtarësimit të BSHBK-se si organizata partnere në Copa Cogeca. Edhe pse kontaktet e para me Copa Cogeca janë iniciuar nëpërmjet z. Wolfgang Jaeger, eksperti gjerman për Organizatat e fermerëve, që nga fillimi i vitit të ardhshëm të do të fillojnë procedurat për pagimin e tarifës së anëtarësimit për vitin 2014 dhe duke u bërë statusi i partner për BSHBK-ne. Siç dihet BSHBK është një organizatë e re e themeluar e fermerëve, në procesin e konsolidimit dhe zhvillimit të kapaciteteve, vitin e



ardhshëm do të jetë koha e përkryer për BSHBK-në të jenë gati për të marrë pjesë në takime dhe ngjarje të zhvilluara në Copa Cogeca . Rezultatet e këtij aktiviteti do të shfaqen gjatë vitit të dytë të implementimit të projektit.

### **Promovimi i Projektit EU-CS**

Eventi i parë promovues i projektit është mbajtur me datën 10 Tetor 2013 në Prishtinë. Në këtë aktivitet ishin 40 pjesëmarrës, përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Financave, MBPZHR, IADK, BSHBK, Fakulteti i Bujqësisë, Banka Botërore, UNDP, NOA/USAID, GIZ-i, si dhe organizata të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, pjesëmarrësit tjerë nga shoqëria civile dhe mediat. Ky event promovues u moderua nga Drejtori Ekzekutiv i IADK-se, z. Zenel Bunjaku. Ftuar në këtë ngjarje ishin edhe z. Christof Stock, Shef i Bashkëpunimit në Zyrën e BE-së në Kosovë, znj. Shqipe Dema, Drejtoreshë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit dhe Kryetare e Autoritetit Menaxhues në MBPZHR, z. Ramadan Avdiu, Zëvendësministër i Financave dhe z. Agim Sahiti, Kryetar i BSHBK-së.

Gjatë eventit promovues janë paraqitur të arriturat e projektit si: Bashkimi i Shoqatave Bujqësore të Kosovës (BSHBK) si organizate, Gazeta Mujore - një dritare të re e informacionit për fermerë dhe ndryshimet në legjislacionin për aplikimin e normës së sheshtë TVSH-se, në të cilat shoqëria civile nga sektori i bujqësisë ishte i përfshirë dhe ka ndikuar fuqimisht këtë proces.

Te arriturat kryesore të projektit si (eventi promovues, konferenca e BON-it dhe ceremonia e certifikimit) janë ndjekur dhe prezantuar nga stacionet kombëtare televizive si (RTK, KTV, RTV21 dhe Klan Kosova), mediat e shkruara dhe elektronike në ueb faqet e tyre.

## **PROMOVIMI SHËRBIMEVE TË TURIZMIT RURAL DHE INFRASTRUKTURËS NË ZONËN E SHALËS**

Projekti financuar nga BE-ja “Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës” në partneritet me Komunën e Mitrovicës dhe Komunën e Vushtrisë ka katër komponentë:

- Ndërtimi i shtegut për këmbësorë dhe biçikletë dhe rregullimi i vend pushimeve për vizitor.

Promovimi i energjisë alternative dhe restaurimi i mullirit tradicional

- Rritja e prodhimtarisë bujqësore dhe përmirësimi i kualitetit të produkteve bujqësore
- Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të fermerëve dhe përmirësimi i shërbimeve për turizëm rural

**Këto komponentë do të realizojnë aktivitetet e mëposhtme:**

- Ndërtimin e shtegut për këmbësorë dhe biçikleta dhe atraksione turistike
- Ndërtimi i katër krojeve për ujë të pijshëm përgjatë shtegut
- Rritja e kualitetit dhe variacioneve të shërbimeve turistike, promovimi i energjisë të prodhuar nga uji dhe restaurimi i Mullirit tradicional të fuqizuar nga uji
- Restaurimi i gjashtë odave/bujtinave tradicionale
- Pajisja e dy restoranteve me biçikleta malore për vizitorë dhe turistë
- Fuqizimi i rolit të femrave në zonat rurale përmes ngritjes së kapaciteteve në sektorin e përpunimit të ushqimit
- Zhvillimi i Ekonomisë së Gjellbër në zonat rurale të shënuara nga projekti nëpërmjet ndërtimit të gjashtë serrave dhe pemishteve prezervuese
- Përkrahja e fermerëve të dhenve, lopëve, deleve, shpezëve-pulave dhe bletarisë.
- Shkëmbimi i eksperiencave me zonat tjera për turizëm rural
- Vizita studimore në zona tjera të përparuara të turizmit në Kosovë dhe në regjionin përreth.
- Publikimi fletëpalosjeve / broshurave

Projekti ka karakter regjional duke marrë parasysh që mbulon komunën e Vushtrrisë dhe Komunën e Mitrovicës. Buxheti total i Projektit është 471,950.00 € nga të cilat 89.58% janë fonde të BE-së kurse komuna e Vushtrrisë kontribuoi në shumën prej 25,000.00 € dhe komuna e Mitrovicës kontribuoi në shumën prej 9,000.00 €. Pjesa tjetër e fondeve mbulohen nga përfituesit të cilët marrin pjesë me 10% të kostos së përfitimit.

### Shtegu për këmbësor dhe biçikleta

Aktiviteti i ndërtimit të shtegut për këmbësorë dhe biçikleta shtrihet në një gjatësi prej 10 km dhe gjerësi prej 1.5 metrave. Shtegu për këmbësor dhe biçikleta kalon në fshatrat: Sllakofc, Skromë, Boshlan, Gumnishtë, Bare dhe Bajgorë. Shtegu për këmbësorë në bazë të planifikimeve në projekt ka pasur gjerësi prej 1.5 m por për shkaqe se



kompania nuk ka mund të ndërtojë me makineri për vetëm këtë gjerësi shtegu ka një gjerësi prej 3m-4m. Për më tepër 10 km janë hapur për kalim pasi që shumica e pjesëve ku kalon shtegu nuk ka pasur fare rrugë. Shtegu ka filluar të vizitohet rregullisht nga turistët të cilët edhe shijojnë peizazhet e bukura të zonës së Shalës.

### Ndërtimi urës tradicionale në fshatin Sllakofc

Një urë me formë tradicionale është ndërtuar në fshatin Sllakofc Komuna e Vushtrrisë; ura gjendet në pjesën ku kalon shtegu për ecje dhe biçikleta. Ura është e dizajnuar bazuar në konceptin tradicional pasi që duam që ura e ndërtuar të jetë atraktive për turistët. Ura është inauguruar në ngjarjen promovuese të organizuar nga Projekti ku Z. Christof Stock dhe Kryetari Komunës së Vushtrrisë morën pjesë. Ura ndërtuar do të shfrytëzohet nga turistët dhe njerëzit që vizitojnë shtegun për këmbësor.



### Ndërtimi i krojeve

Katër kroje në katër lokacione [2] kroje në Skromë, [1] në Gumnishtë dhe [1] në Bajgorë janë ndërtuar për turistët që vizitojnë zonën e Shalës. Krojet janë të mbuluara me rrasa guri në mënyrë që të kenë koncept tradicional dhe të jenë atraktive për turistët që vizitojnë këtë zonë. Krojet ofrojnë një vend për pushim për ata turistë që shfrytëzojnë shtegun me biçikleta dhe ecje. Si rezultat i ndërtimit të krojeve më shumë se 50 turistë i shfrytëzojnë këto kroje gjatë një fundjave në mot të mirë.



### Restaurimi i mullirit me ujë në fshatin Samadrexhë

Aktiviteti ka paraparë restaurimin e mullirit me ujë me një pamje atraktive dhe tradicionale për turistët aktivitet ky i zbatuar pikërisht si është planifikuar. Për më tepër, ne kemi përkrahur mullirin me ujë me një verandë ku vizitorët mund të shijojnë kohën e kaluar tek mulliri me ujë dhe të mësojnë rreth funksionimit të mullirit. Mulliri me ujë i restauruar u inaugurua në ngjarjen promovuese të projektit të organizuar nga projekti. Përfituesi i mullirit të restauruar nga Shtatori 2013 ka gjeneruar më shumë se 10,800 € dhe më shumë se 20 turistë kanë vizituar mullirin me ujë gjatë fundjavës.



### Promovimi energjisë alternative për prodhimin e energjisë nga uji

Kanë filluar përgatitjet për këtë aktivitet për instalimin e turbinës për prodhimin e energjisë nga uji në kapacitet prej 12.5 KW. Aktiviteti do të realizohet në fshatin Sllakofc dhe do të përfundojë vitin e ardhshëm të zbatimit të Projektit më 2014.

### Restaurimi i tri odave/bujtinave për turistë

Tri oda/bujtina janë dizajnuar dhe projektuar nga zyrtarët e IADK-së për dukje si oda/bujtina tradicionale dhe të qenit komod në të njëjtën kohë. Përfituesit nga fshatrat: Sllakofc, Bare dhe Bajgorë janë të kënaqur me investimet e bëra nga IADK dhe janë pajtuar që të njëjtat oda/bujtina të adaptuara ti shfrytëzojnë për akomodimin e turistëve. Të tre përfituesit janë trajnuar për shërbime turistike dhe aspekte ekonomike.



Përfituesit do të akomodojnë turistët dhe do ti ofrojnë ushqim në rast se kërkohet me pagesë. Përfituesit do të monitorohen ku gjatë kësaj kohe të monitorimit do të shiqohen shitjet, do të reklamohet akomodimi dhe do të asistohen përfituesit për të gjithë procesin e mikpritjes për turistë. Tri oda/bujtina shtesë do të adaptohen në vitin e dytë të projektit më 2014.

### Vizita studimore në regjionet tjera të avancuara në Kosovë dhe regjion

Një vizitë studimore u mbajt ku kanë marrë pjesë 14 pjesëmarrës [përfitues të odave/bujtinave, biçikletave, trajnimeve dhe nga mulliri me ujë i restauruar]. Vizita u mbajt në Regjionin e Pejës dhe për më tepër grupi ka vizituar një projekt të zbatuar nga EURED në komunën e Pejës tek “Gryka e Rugovës” të cilët kanë pasur aktivitete të turizmit rural.



Po ashtu është vizituar mulliri me ujë “Mulliri Haxhi Zekës” i cili është restauruar por nuk është funksional. Pjesëmarrësit kishin rastin të përjetojnë mikpritjen turistike në mullirin me ujës dhe të shohin për së afërmi se si tregohet një storie për turistë. Vizita studimore u ndal në stacionin e fundit të planifikuar në Deçan në kullën e restauruar “Kulla e Mazrekajve”



### **Trajnimet në aspektin ekonomik**

Trajnimet në aspektin ekonomik janë mbajtur në fshatin Sllakofc dhe Bajgorë për të gjithë përfituesit e projektit sikurse: përfituesit nga restorantet, përfituesit e odave/bujtinave, përfituesit e trajnimit të ushqimit, përfituesit e serrave, përfituesit e pulave, përfituesit e pemishteve dhe të gjithë përfituesit tjerë të interesuar.

### **Ueb Faqja**

Një ueb faqe është zhvilluar dhe lëshuar në funksion për turistë e interesuar të mësojnë rreth zonës së Shalës. Ueb faqja përmban informata për të gjithë projektin dhe për të gjitha mundësitë e turizmit që kjo zonë ofron.

Ueb faqja është: [www.shalatourism.org](http://www.shalatourism.org)

### **Ngjarja Promovuese**

Projekti ka mbajtur ngjarjen promovuese për Projektin me datën 16 Shtator 2013 ku më shumë se 50 pjesëmarrës ishin prezentë dhe mediat gjithashtu. Ngjarja promovuese u nderuar edhe me prezenën e Shefit të Operacioneve Z. Christof Stock dhe Kryetarit të Komunës së Vushtrisë Z. Bajram Mulaku. Ngjarja filloi me vizitën tek mulliri me ujë i restauruar për të vazhduar pastaj tek përfituesit e serrave dhe pulave. Pas kësaj ura e ndërtuar në kuadër të projektit u inaugurua dhe u përmyll me fjalimet e mbajtura nga folësit e ngjarjes për ta finalizuar me një koktej me ushqime tradicionale të përgatitura nga grupet e grave të trajnuara nga IADK.. Ngjarja u transmetua nga Televizioni Publik “RTK” për rreth 2 minutave dhe nga Televizioni Nacional “Klan Kosova” për rreth 1.5 minutave; për më tepër portalet online gjithashtu shkruan rreth ngjarjes.

### **Broshurat dhe pamfletet**

Gjatë kohës së zbatimit të projektit janë printuar pamfletet për promovimin e projektit dhe aktiviteteve dhe atë në tri gjuhë: Shqipe, Serbe dhe Angleze. Për më tepër, ne kemi dizajnuar dhe printuar broshurën në Shqip dhe Anglisht e cila u shpërnda gjatë ngjarjes promovuese të projektit.



Në këtë aktivitet në përgjithësi janë publikuar 1,000 pamflet dhe 500 broshura të cilat janë shpërndarë tek të gjithë palët e interesit të projektit.

## PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2013 IADK ka përgatitur dhe publikuar 3 broshura dhe 17 fletëpalosje në të gjithë sektorët e bujqësisë. Broshurat dhe fletëpalosjet janë përgatitur në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Broshura **“Mbajtja e shënimeve në fermë ”** – përmban informata të rëndësishme se si të mbahen shënimet në fermë, të hyrat dhe të dalat, asetet si dhe tri deklaratat financiare: qarkullimi i të hollave, deklarata e fitimit dhe humbjes dhe fleta e bilancit.

Broshura **“Përpunimi shtëpiak i pemëve perimeve dhe qumeshtit”** – përmban përmbledhje lehtësisht të kuptueshme për përpunimin e qumeshtit, pemëve dhe perimeve, higjienën receptura të ndryshme për përpunim dhe ruajtjen e tyre.

Broshura **“Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës”**- përmban aktivitet e parapara të projektit dhe rezultateve të projektit .



**Fletëpalosjet:** “Pasterizimin e qumeshtit me anë të nxemjes së ujit me panela solar”, “Tharjen e bimëve mjekësore me panela solar” dhe “Pompimin e ujit me anë të shfrytëzimit të energjisë fotovoltaike”, “Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës”, “Prodhimtaria organike e bimëve mjekësore”, “Shoqata e grave Begatia”, Shoqata e Grave – Vullneti i Grave”, Shoqata e grave Konvita”, Shoqata e grave Radosava Mirkoviq”, “Përpunimi shtëpiak i pemëve dhe perimeve”, “Shijo produkte të shëndetshme dhe tradicionale”, Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për politik bërje konsultim me Qeverin në sektorin e Bujqësisë”, “Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në Zonën e Shalës”, “Bashkimi shoqatave bujqësore të Kosovës”, “Prodhimtaria organike e perimeve”.

## PANAIRE

Për të promovuar produktet bujqësore të fermerëve dhe vënien e kontakteve të drejtëpërdrejta të prodhuesve, përpunuesve dhe konsumatorëve IADK ka vazhduar përkrahjen dhe bashkëpunimin me akterë të ndryshëm në organizimin e panairove të prodhimeve bujqësore, si në nivelin regional ashtu edhe në atë nacional.

### Panairi Regional i Produkteve Bujqësore “Mitrovica 2013”

Unioni i Shoqatave të Fermerëve të Regjionit të Mitrovicës është duke duke mbajtur në kontinuitet dhe ka bërë tashmë tradicional organizimin e panairit të produkteve bujqësore. Këtë vit në mbështetje të disa sponsorëve përfshirë këtu

edhe IADK-në USHFRM ka organizuar Panairin e Produkteve Bujqësore “Mitrovica 2013”, i cili është mbajtur në Mitrovicë nga data 5-7 Shtator 2013. Organizimi i panairove është duke marrë një rol të rëndësishëm dhe interesim të fermerëve për të prezentuar prodhimet e tyre bujqësore, ngase përveç shitjeve direkte aty po vëhen edhe kontakte të fermerëve dhe konsumatorëve dhe kështu vërehet një lehtësim i plasimit të produkteve, përmes organizimeve të këtilla.

### **Panairi i produkteve bujqësore “Kosova 2013”**

Në Prishtinë nga data 2-5 Tetor 2013 është mbajtur Panairi i Produkteve Bujqësore “Kosova 2013”, i organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, ku edhe IADK ka dhënë një kontributë të veçantë si në organizimin e fermerëve për pjesëmarrje në panair ashtu edhe në përkrahjen klientëve të vetë (fermerëve dhe grupeve të grave), për të cilët është siguruar një hapësirë prej 80 m<sup>2</sup>. Gjatë këtyre ditëve pjesëmarrësit kanë ekspozuar produktet e tyre, me ç’rast duke plasuar produktet ata kanë vënë edhe kontakte me konsumatorë apo klient të rinjë, nga edhe është lehtësuar puna në plasimin e prodhimeve të tyre.



### **AKTIVITETE ME PARTNERË PROFESIONAL INTERNACIONAL Ekspertët Seniorë të PUM nga Holanda**

*Në sektorin e blegtorisë* gjatë vitit 2013 është realizuar 1 mision nga një ekspert nga organizata PUM. Gjatë këtij misioni fermerët janë trajnuar dhe janë këshilluar në përgatitjen e ushqimeve për kafshe, balancimin e racioneve ushqimore, përgatitjen e silazhit të barit dhe misrit dhe të ushqyerit e lopëve në bazë të prodhimtarisë. Gjate këtij misioni janë trajnuar 32 fermer dhe 11 student të fakultetit të Bujqësisë.

*Në sektorin hortikulturës* janë realizuar 2 misione me ekspertët e organizatës PUM. Njeri mision ka qenë në sektorin e prodhimtarisë së integruar ku janë trajnuar fermerët në kultivimin e fidanëve të mollës, krasitjen e gjelbër ku janë trajnuar 51 fermer dhe 21 student. Ndërsa misioni i 2-të ka qenë në sektorin e prodhimtarisë organike ku fermerët janë trajnuar në prodhimin organik të bimëve mjekësore, organizimin e fermerëve në kooperativa dhe si të punohet në bazë të standardeve Global GAP dhe standardeve të EU. Gjatë këtij misioni janë trajnuar 14 fermer.

*Në sektorin e përpunimit* është angazhuar 1 ekspert për përpunimin e ushqimit e cila është fokusuar në standardizimin e produkteve ushqimore, kryesisht prodhimet shtëpiake. Gjate këtij misioni janë trajnuar 97 fermer dhe 3 studente. Me qëllim të përmirësimit të komunikimit me media të stafit të IADK-së, gjatë këtij viti është angazhuar një ekspert nga organizata PUM në trajnimin e stafit për

komunikim me media. Gjatë këtij misioni stafi i IADK-së është trajnuar në mënyre praktike në përmirësimin e teknikave të komunikimit me media, gjatë këtij misioni është trajnuar i gjithë stafi i IADK-së i përbërë nga 19 personave.

Një misione është realizuar nga një ekspert i Shqipërisë në sektorin e hortikulturës për prodhimtari të integruar dhe organike të pemëve dhe perimeve.

### **Shkëmbimi i përvojave me organizatën AFDI nga Franca**

Edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar bashkëpunimi me shoqatën AFDI në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë. Gjatë vitit 2013 përfaqësuesit e AFDI-të kanë realizuar një vizitë në Kosovë me qëllim që t'u ndihmohet fermerëve në menaxhimin sa më të mire të fermave në rritjen e produktivitetit të fermës. Po ashtu gjatë këtij misioni është bërë evoluimi i aktiviteteve që ka pasur AFDI dhe IADK.

Po ashtu gjatë këtij vitit IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë ku kanë marrë pjesë 2 përfaqësues të Shoqatës së Deleve dhe Dhive të Kosovës dhe një veterinar nga komuna e Mitrovicës. Vizita ka zgjatur 10 ditë dhe qëllimi kryesor i vizitës ka qenë që pjesëmarrësit të njihen me praktikën e reja në menaxhimin e fermave, organizimin e fermerëve, funksionimin e shoqatave të fermerëve.

### **Implementimi i standardit ISO 9001-2008 në IADK**

Gjatë vitit 2013 IADK është certifikuar me standardin ISO 9001-2008 nga shtëpia certifikuese e Bureau Veritas. Si organizatë joqeveritare IADK është specializuar në fushën e ofrimit të shërbimeve e cila merret me:

*Ofrimin e shërbimeve konsulente, projektimin dhe zbatimin e projekteve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe organizimet e fermerëve.*

Qëllimi i organizatës është ofrimi i shërbimeve dhe produkteve cilësore që i përmbushin plotësisht kërkesat e klientëve tanë dhe kërkesat ligjore, sigurimi i një gjendje të qëndrueshme financiare dhe përmbushja e interesave të organizatës.

### **Tregim suksesesi për fermer**

Fermeri Sami Sylejmani vjen nga një fshatë malorë që gjendet afër maleve të Çiçavicës, përkatësisht në fshatin Shallc, në të cilin ekzistojnë kushte të përshtatshme për t'u marrë me bujqësi. Ai jeton në bashkësi familjare me gjithsejtë 14 anëtarë të familjes, të cilët si burim të vetëm të të hyrave kanë të ardhurat nga punët në bujqësi. Përkrahjen e parë që ka marrë kjo familje në kuadër të përpjekjeve të donatorëve për krijimin e kushteve të fermerëve për qëndrim në fshat, ka qenë përfitimi i pesë shoqërive të bletëve me disa pajisje tjera përcjellëse, të dhuruara nga LWF-Programi i bujqësisë, në vitin 2004. Si fillestar në këtë lëmi por shumë i përkushtuar për punë, duke përcjellur me



kujdes edhe trajnimet e ndryshme për bletari, Samiu vit pas viti ka zgjeruar punën me bletari dhe sot ka mbi 70 shoqëri bletësh, duke perfeksionuar mjaftë mirë këtë lëmi.

Duke qenë se familja ishte me gjendje jo të mirë ekonomike dhe duhej bërë përpjekje të ndryshme për të përmirësuar gjendjen ekonomike familjare, ata kishin filluar në një sipërfaqe shumë të vogël me kultivimin e feferonëve në fushë të hapur dhe pas vjeljes edhe konservimin e tyre. Në vitin 2011 ai përcjellë një modul të trajnimeve në



IADK që përbante 12 sesione praktike të kultivimit të perimeve dhe 7 sesione në menaxhim të biznesit të fermës, ku edhe merrë njohuri shtesë në avancimin e prodhimitarisë së perimeve në serrë, dhe si rezultat arriti të zgjeroji sipërfaqet me serra edhe për 800 m<sup>2</sup>. Bazuar në punët e sukseshme që ai ka arritur në vazhdimësi si dhe nevojën për përkrahje të mëtejshme sidomos në prodhimitarinë e perimeve, IADK në kuadër të projektit EcoFK ka përzgjedhur këtë fermerë për të filluar me prodhimitarinë organike të perimeve në serra. Fermeri është përkrahur në ngritjen e një serre moderne me sipërfaqe prej 500 m<sup>2</sup> dhe inpute e pajisje tjera përcjellëse. Kjo serrë është ngritur në fshatin Stanofc i Ulët të Vushtrisë dhe do të shërbejë si qendër për demonstrimin e praktikave të rritjes së perimeve në mënyrë organike edhe për fermerët tjerë nga gjithë Kosova, të cilët duanë të kalojnë nga prodhimitaria konvencionale në atë organike.

Serra është mbjellë me domate në gjysmën e dytë të muajit maji ku janë mbjellë 1100 fidanë të domates apo 2.2 bimë për m<sup>2</sup>. Plehrimi i tokës është bërë vetëm me plehë të shtallës, i cili është marrë nga një fermë e deleve në një fshatë malorë, dhe nuk janë përdorur fare plehurat minerale. Edhe sa i përket mbrojtjes së bimëve nuk është bërë asnjë trajtim kundër sëmundjeve apo dëmtuesve, kjo për faktin se janë marrë masat e përkujdesit në mënyrë të rregullt, si ajrosja e serrës sidomos në kulmin e serrës, ujitja pikë-pikë, vendosja e rrjetës anti-insekt në dritaret anësore, dhoma parahyryse, dendësia e vogël e bimëve dhe përkujdesi i rregullt që fermeri ka bërë gjatë vegjetacionit të bimëve.


Deri në dhjetë ditëshin e parë të muajit tetor fermeri ka vjelë rrethë 5 tonë të domateve, dhe çmimi i shitjes mesatarisht ka qenë 0.40-0.50 €/kg, i cili nuk ka dalluar shumë nga ai i domateve tjera për faktin se ky ka qenë viti i parë i fillimit të kalimit në prodhimin organik, dhe në vitin tjetër fermeri do të përkrahët në programin e certifikimit dhe inspektimit organik, për të cilën gjë është kontraktuar një trupë inspektuese/certifikuese nga Shqipëria (Albinspekt), dhe pas certifikimit të prodhimeve si organike do të bëhet promovimi dhe marketingu i këtyre prodhimeve, e që do të ndihmojë edhe plasimin e produkteve me çmim më të favorshëm.

### Vizitat me fermerë dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme gjatë vitit 2013


Nr	Vendi	Nr. i ditëve	Nr. i pjesm.	Tema
1	Kosovë	1	5	Hortikulturë
2	Kosovë	1	9	Përpunim i ushqimit
3	Kosovë	1	14	Përpunim i ushqimit
4	Kosovë	1	15	Hortikulturë
5	Kosovë	1	15	Turizëm Rural
6	Shqipëri	2	1	Workshop FOA
7	Shqipëri	3	17	Grupi i fermerëve që zbatojnë IP në Serra
8	Shqipëri	3	16	Vizitë Relax Stafi 2013
9	Shqipëri	1	1	Seminar i Organizuar nga MAFRED
10	Shqipëri	2	17	Fermer kultivues të Mollës
11	Shqipëri	1	17	Prodhimtaria organike e perimeve në Serra
12	Shqipëri	1	14	Zbatimi i IP në Serra
13	Shqipëri	1	1	Konferenca e BAAN
14	Shqipëri	2	1	Rivitalizimi i pemtarisë, perimtarisë
15	Serbi	1	2	Prodhimi i fidaneve në fushë te hapur
16	Maqedoni	3	12	Vizitë me fermer (Shkup,Gostivar)
17	Maqedoni	2	7	Visiti studimore me BSHBK-në
18	Maqedoni	1	2	Projekti potencial CBC-Kumanovë
19	Holand	7	2	Vizitë studimore në Holand
20	Holand	7	2	Vizitë studimore në Holand
21	Holand	6	2	Vizitë studimore në Holand
22	Holand	7	2	Vizitë studimore në Holand
23	Francë	5	6	Antarët e BSHBK-së
24	Francë	10	4	Vizitë studimore në Francë
25	Gjermani	8	1	Konferencë në Gjermani dhe Cona(Austri)
26	Turqi	90	2	Intership
27	Çeki	5	1	Vizitë në Pragë
28	Itali	1	1	Vizitë studimore Bari
29	Zvicërr	1	1	Vizitë studimore-Fibl
<b>Totali</b>		<b>175</b>	<b>190</b>	

**Të hyrat e IADK-së nga Partnerët dhe Donatorët për vitin 2013**

	<b>Emri i Donatorit/Partnerit</b>	<b>Emri dhe Kohëzgjatja e Projektit</b>	<b>Shuma €</b>	<b>Përqi ndja %</b>
1	Zyra e Komisionit Europian në Kosovë	Promovimi i Bujqësisë, Hortikulturës, Blegtorisë dhe Përpunimit të frutave në Regjionin e Mitrovicës (2010-2012)	30,218	2.3%
2	Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë	Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile në bërjen e politikave dhe dialogut me Qeverinë në sektorin e Bujqësisë (2012-2014)	110,857	8.6%
3	MBPZHR		8,000	0.6%
4	Zyra e Komisionit Europian në Kosovë	Promovimi i turizmit rural dhe infrastrukturës në regjionin e Shalës	380,498	29.5%
5	Komunat		16,250	1.3%
6	Fin Church Aid	Edukimi dhe Konsolidimi I Fermerëve në Kosovë (2012-2014)	142,000	11.0%
7	Evangelischer Entwicklungsdienst-EED		198,100	15.3%
8	Church of Sweden		116,759	9.0%
9	Evangelischer Entwicklungsdienst-EED	Qendra për Edukimin e Fermerëve (2012-2015)	212,393	16.4%
10	MBPZHR	FADN - Të dhënat për fermerë	13,250	1.0%
11	Oda Ekonomike e Kosoves	Trajnime në prpunim me grupin e grave	4,311	0.3%
12	Te hyrat Tjera (AFDI,PUM,CPMP,D renas)	Projekte tjera 2013	5,687	0.4%
16	Kontributi Lokal	Projektet 4,6,7,8	53,451	4.1%
	Gjithsej		1,291,774	100%



	Emri I Sektorit	Shuma € për 2013	Përqindja %
1	SEKTORI I HORTIKULTURES	220,947	20%
2	SEKTORI I BLEGTORISE	144,372	13%
3	SEKTORI I PERPUNIMIT	85,833	8%
4	ORGANIZIMI I FERMEREVE	98,606	9%
	TURIZMI RURAL	144,522	13%
5	SHPENZIMET KAPITALE PER QENDREN EDUKUESE BUJQESORE	302,907	28%
6	SHPENZIMET ADMINISTRATIVE	88,534	8%
	<b>Total</b>	<b>1,085,721</b>	<b>100%</b>





**Stafi i IADK-së për vitin 2013**

<b>Emri&amp;Mbiemri</b>	<b>Departamenti</b>	<b>Pozita</b>
Zenel Bunjaku	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
Gursel Arifi	Blegtori	Zv. Drejtor dhe Udhëheqës i Departamentit të Blegtorisë
Esmā Azemi	Financa	Menaxhere për Financa
Basri Hyseni	Hortikulturë	Udhëheqës i Departamentit të Hortikulturës
Ariana Selmani	Financa	Zyrtare për Financa dhe Administratë
Elheme Shala	Administratë	Asistente e zyres
Petrit Koci	IT / Administratë	Ndihmës i IT-së
Sylejman Bunjaku	Perimtari	Inxhinier i Bujqësisë
Xhavit Shala	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
Skender Fejzullahu	Pemëtari-Hortikulturë	Asistent i Hortikulturës
Magbule Hyseni	Përpunim	Udhëheqëse e Sektorit të Përpunimit
Hanumshahe Zeneli	Përpunim	Zyrtare Projekti
Hafize Veseli	Përpunim	Zyrtare Projektit – Përpunim
Edvin Kotherja	Projekti i shoqërisë civile	Projekt Menaxher
Kreshnik Sadiku	Turizmi Rural	Projekt Menaxher
Veton Maloku	Turizem Rural	Inxhinier i Ndertimtarisë
Avni Ramadani	Projekti i shoqërisë civile	Projekt Menaxher
Bujar Ahmeti	Projekti i shoqërisë civile	Zyrtar i Projektit
Novica Markovic	Hortikulturë	Inxhinier i Hortikulturës
Valmira Hetemi	Financa	Praktikante-Asistente e Financave
Edita Mahmuti	Hortikulturë	Praktikante – Asistente e Bujqësisë

**Konsulentet e jashtëm dhe të brendshëm gjatë vitit 2013**

<b>Nr.</b>	<b>Emri&amp;Mbiemri</b>	<b>Pozita</b>
1	Sabri Musiqi	Mbikqyrës i elektrikës
2	Elez Abazi	Ndërtimi i stendave
3	Bajram Istrefi	Ndërtimi i kafazeve
4	Halil Bajrami	Trajnues për shërbime turistike
5	Ali Lushi	Trajnues për cëshjte ekonomike
6	Zenel Elshani	Trajnues dhe përkthyes
7	Habib Meholli	Përkthyes
8	Albana Gashi	Përkthyes
9	Shqipe Syla	Promotere e stendës
10	Blerina Halilaj	Promotere e pikës
11	Arta Hasani	Promotere e pikës
12	Bernd Sitzmann	Energjia alternative
13	John Milligan	Azhorimi i manualeve
14	Wolfgang Jaeger	Eksperti për BSHBK
15	Mojca Hrabar	Monitorim dhe raportim
16	Radovan Jovanovic	Perkthyes
17	Emina Hyseni	Perkthyes
18	Veton Galica	Perkthyes
19	Xhevat Muharremi	Perkthyes

**Praktikantet gjatë vitit 2013**

<b>Nr.</b>	<b>Emri&amp;Mbiemri</b>	<b>Departamenti</b>	<b>Pozita</b>
1	Luan Tiriqi	Hortikulture	Praktikante
2	Gani Kerolli	Hortikulture	Praktikante, Enumerator
3	Ridvan Osmani	IADK	Praktikant
4	Agron Bunjaku	IADK	Enumerator
5	Mahir Dauti	IADK	Enumerator
6	Vlora Zymberi	Financa	Praktikant
7	Mirjeta Ademi	Perpunim i ushqimit	Praktikant

## Qendra Edukuese e Fermerëve – Vushtrri





INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO  
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS  
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

## QENDRA EDUKUESE E FERMERËVE VUSHTRRI



Adresa:  
Fshati Sfarraqak i Ulët, p.n  
42000 Vushtrri  
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!  
Let us live from our land and work!*

E-mail: [info@iadk.org](mailto:info@iadk.org)  
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726  
Web: [www.iadk.org](http://www.iadk.org)